

DI
DRITA ISLAME



Dashuria për Profetin Muhamed (a.s.)



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit
Nr. 10 (485)
Tetor, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Dashuria për Profetin (a.s.) është dashuri për Allahun (xh.sh.) / Mehmet Disha
- 6 Parapëlqimi i botës ndaj ahiretit, sëmundja më e madhe e epokës sonë / Tauland Bica
- 8 **Lajme / Aktivitete**



- 12 Kur feja mësohej në shkollë / Hasan Bello
- 16 Alternativat e kamatës në financimin e kapitalit të sipërmarrjeve / Enklid Pelari
- 20 Gusuli te gratë / Fatma Karaj
- 22 Mëkati dhe pasojat e tij në jetë / Mustafa Prijaça
- 26 Vlera e punës në këndvështrimin Islam / Erjod Haxhiu
- 28 Rënkimi i mjedisit / Pr. Dr. Suat Yldirim
- 32 Profeti ynë u dërgon letër mbretërve të kohës për t'i ftuar edhe ata në islam I / M. Jusuf Kanderleui



- 34 Rëndësia e gjuhës në jetën e një populli / Jolanda Kodra
- 36 Hasan Selami (1910-1943) / Redaksia
- 38 Divorci nuk është e vetmja zgjidhje / Aisa Kokëçi



Dashuria për Profetin (a.s.) **është dashuri për Allahun (xh.sh.)**

Çdo namaz që falet, çdo agjërim që mbahet, çdo punë e mirë që kryhet dhe çdo frymëmarrje që konsumohet në rrugën e Islamit, ka si qëllim fitimin e kënaqësisë së Zotit. Mënyra më e përshtatshme për ta fituar këtë kënaqësi është ndjekja e udhëzimit të Profetit Muhamed a.s. dhe marrja e tij si shembullin më të përkryer të mënyrës sonë të të jetuarit.

Zoti i Lartësuar na urdhëron bindjen ndaj Profetit a.s. në zgjidhjen e problemeve tona, të mëdha apo të vogla qofshin ato, dhe respektimin e çdo mendimi të hedhur prej tij, duke na paraqitur bindjen dhe respektin si imperativ të besimit islam. Në Kur'an thuhet:

"Për Zotin tënd, ata nuk do të besojnë në të vërtetën dhe nuk do të jenë të përlur para saj, deri atëherë kur të caktojnë ty të gjykosësh për mosmarrëveshjet që kanë mes tyre, duke mos e ndjerë veten ngushtë për gjykimin që do t'u bësh dhe duke qenë të bindur para teje, siç janë besimtarët e sinqertë." (Nisa, 65)

Zoti i Lartësuar në këtë ajet na tërheq vëmendjen në tre pika:

1. Për zgjidhjen e çdo problemi, pikë së pari, të marrim

në konsideratë vlerësimet dhe gjykimet e Profetit a.s., për problemin në fjalë ose të ngjashëm me të.

2. Zgjidhjet dhe gjykimet që na vijnë nga ai a.s., të zënë vend në zemrat dhe mendjet tona si zgjedhjet dhe gjykimet më të mira.

3. Bindja dhe respekti për të të jenë të sinqerta.

Kur'ani lajmëron se, për besimtarët nuk mund të ketë zgjidhje tjetër përveç dorëzimit absolut.

"Nuk i lejohet asnjë besimtari e besimtareje që të bëjnë zgjedhje tjetër në gjykimin e çështjeve që kanë, kur këto çështje i ka gjykuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, e kush kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij është larguar shumë prej rrugës së drejtë." (Ahzab, 36)

Mosbindja ndaj Pejgamberit a.s. është njëkohësisht kundërvënie ndaj tij dhe rebelim ndaj Zotit të Madhëruar. Çdo ndjenjë dhe veprim që demonstron ndaj Profetit a.s., në të vërtetë i është demonstruar Allahut xh.sh.

Në disa ajete kuranore, mospajtimi me Pejgamberin a.s., tregohet si shkak i deviacioneve, humbjeve dhe fatkeqësive.

"Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që



ia bëni njëri-tjetrit; Allahu, me siguri, i di ata që largohen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.” (Nur, 63)

Kurse në suren Nisa, ajeti 115, thuhet: “Kush është në kundërshtim me të Dërguarin pasi është bërë e qartë e vërteta dhe udhëzimi për në rrugë të drejtë dhe nuk ndjek rrugën e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisar...”

Në këtë kuadër mund të përmendim edhe disa hadithe të Pejgamberit a.s.

“Kush më bindet mua, i është bindur Allahut dhe kush më ngre krye mua, i ka ngritur krye Allahut.” (Buhariu)

“Përveç të shmangurve, i gjithë umeti im do të zërë vend në xhenet”, ka thënë në një rast Pejgamberi a.s. Ata që ishin me të e pyetën se kush janë të shmangurit? Atëherë ai iu përgjigj: “Të shmangurit janë ata që nuk i binden porosive të mia të sjella nga Allahu”.

Vetëm disa prej shokëve të tij e kanë përshkruar fytyrën e Profetit a.s. A e dini shkakun e kësaj? Kjo ndodhte, sepse pjesa më e madhe e tyre nuk guxonin ta shihnin

gjatë në fytyrë për shkak të bukurisë së tij.

Ai u krijua siç mund të krijojë Zoti i gjithësisë krijesën e Tij më të bukur. Nëse e do bukurinë, duaje profetin Muhamed a.s., se është kulmi i bukurisë. Në qoftë se njeriu i do cilësitë e mira, dije se ai ishte kulmi i cilësive më të mira. Ishte ai njeri, që s’e edukoi as prindi, as babai, as nëna, as mësuesja, as shoku, por që e edukoi vetë Zoti i gjithësisë. Për këtë Profeti a.s. ka thënë: “Mua më ka edukuar Allahu dhe m’i ka përsosur cilësitë dhe moralet e mia.”

Çdo pretendim ka faktin dhe argumentin e tij. Dashuria për Profetin a.s., që e shprehim me gjuhët tona, që e duan zemrat tona dhe, me lejen e Zotit, e realizojmë në jetën tonë, duhet të ketë fakte. Le të tregojmë se e duam vërtet Profetin a.s., sepse dashuria për të është dashuri për Zotin e gjithësisë.

Mehmet Disha

PARAPËLQIMI I BOTËS NDAJ AHIRETIT, SËMUNDJA MË E MADHE E EPOKËS SONË

Nëse e doni botën për shkak të fytyrës së saj tërheqëse ndaj dëshirave dhe epsheve tona, atëherë, me vetëdije dhe dëshirë do ta preferoni atë ndaj ahiretit, veçori e cila fatkeqësisht është sëmundja më e madhe e kohës sonë. Sot, bukuritë joshëse të botës ua trullojnë kokën shumë njerëzve. Madje edhe ata që duket se besojnë janë të lidhur me botën me gjithë zemër. Ata e adhurojnë këtë botë dhe e parapëlqejnë atë ndaj ahiretit. Vrapojnë pas saj sikur nuk do të vdesin kurrë dhe e kalojnë jetën në ndjekje të ambicieve të tyre të vogla.

Adhurimi i atyre njerëzve që zemrat e të cilëve janë të lidhura ngushtë me këtë botë, nuk shkon kurrë përtej formës. Ndërsa e dimë që në adhurim është e rëndësishme lidhja e zemrës me Allahun. Është lidhja e çmendur e njeriut me Të. Është ta

adhurosh me dashuri dhe me emocionin sikur po të del zemra nga vendi. Është që, në lutjet drejtuar Tij, të derdhen rënkimet e zemrës në buzë. Është që të dish se asgjë nuk mund të vendoset para Tij.

Rëndësia e sinqeritetit në adhurim ndaj Allahut

Ashtu siç zhduken yjet në qiell kur dielli lind, po ashtu zhduken bukuritë tërheqëse të botës në sytë e një personi që sinqerisht i drejtohet Allahut. Madje, shpeshherë ndodh që një person i tillë nuk e sheh as veten e tij.

Siç ka thënë edhe Said Nursiu, epoka jonë është epoka e atyre që qëllimisht preferojnë botën ndaj ahiretit dhe fatkeqësisht, halli më i madh edhe i atyre që shkojnë në xhami, edhe i atyre që shkojnë në Qabe edhe i atyre që ngrenë duart në Arafat,

është gjithashtu kjo botë. Nëse do ti dëgjonim zërat e tyre gjatë lutjes, do të dëgjoni se kërkesat e tyre shpeshherë përbëhen nga përfitime të kësaj bote. Madje shpeshherë e bëjnë adhurimin dhe robërinë e tyre ndaj Allahut një mjet për përfitime të kësaj bote. Ashtu si thotë edhe Pejgamberi jonë i dashur se ka shumë njerëz që falin namazin dhe si shpërblim marrin lodhjen dhe pagjumësinë ashtu siç ka shumë njerëz që agjërojnë dhe si shpërblim marrin etjen dhe urinë. Megjithatë, ajo që është thelbësore në adhurim është sinqeriteti. Nëse në adhurimin tonë ndaj Allahut fusim pasurinë, frikën për të ardhmen, familjen, fëmijën, pozitën, gradën, reputacionin etj., do ta ndosimi atë. Por ja që fatkeqësisht, jemi në epokën e adhuruesve të botës dhe është me të vërtetë shumë e vështirë të qëndrosh larg këtij rreziku.

Reziku i shekullarizimit dhe kurimi i tij

Shikoni se si e portretizon Kurani këtë të vërtetë të epokës sonë:

“E vërteta është se ju jeni shumë të dhënë pas jetës së pasigurt të kësaj bote. Prandaj e neglizhoni, e injoroni ahiretin”. (Kur’an, 75:20-21)

Sot, nëse ka një sëmundje që është më e rrezikshme se murtaja, lebroza, sida, ajo është sëmundja e vënies së botës në radhë të parë aq sa ndot edhe robërinë, adhurimin ndaj Allahut. Këdo që infekton ky virus, e hedh atë përtokë. Një person i tillë, është e pamundur të mbijetojë. Prandaj dhe duhet ti lutemi shumë Allahut që, përveç të këqijave dhe pengesave të shumë njerëzve të këqinj, besimtarët që Allahu i Madhëruar i ka bërë të suksesshëm në shërbime të rëndësishme të amanetit hyjnor, ti mbrojë nga ky virus i rrezikshëm. Vetëm me lutje dhe me mbrojtjen e Tij mund ti mbijetojmë sëmundjeve të ahir zamanit (kohës).

Një mënyrë e rëndësishme për të mos rënë në vorbullën e dynjasë është të lidhësh zemrën me ëndrrat e larta dhe të mbyllesh në realizimin e atyre idealeve. Në fakt, për ata që kanë si ideal njohjen e njerëzve të të katër anëve të botës me emrin më të bukur njerëzorë, njohjen me Muhamedin a.s, nuk mund të mendohet se e lidhin zemrën e tyre me gjëra më të ulëta. Sepse një ideal i tillë i lartë është më i rëndësishëm se pozitat dhe gradat botërore, apo edhe formimi i qindra perandorive në botë. Një person që dëshiron ahiretin nuk mund t’i japë rëndësi fytyrës së botës sado e bukur dhe tërheqëse të jetë ajo. Ata që i drejtojnë sytë nga Allahu i Madhëruar, shmangin çdo gjë tjetër dhe pushojnë së kërkuari një kible tjetër ku të kthehen përveç Tij. Edhe sikur bota do të qëndronte para tyre me të gjitha bukuritë, shkëlqimin dhe joshjen e

saj, ata do ta shihnin atë si diçka të mjegullt, dhe të pistë. Ndoshta nuk do ta shihnin fare.

Ashtu si na e ka shpjeguar edhe i Dërguari i Allahut i cili ka thënë se:

“Sikur dynjaja të kishte vlerë tek Allahu qoftë edhe sa krahu i një mize, Ai nuk do t’ia mundësonte jobesimtari të pinte as edhe një gllënjë ujë prej saj.” (Tirmidhiu, zuhd 13; Ibn Maxhe, zuhd 3)

Kjo pra është vlera e botës. Një njeri që u dërgua në këtë botë me një potencial të lartë, pse duhet të aspiroi një gjë kaq të thjeshtë! Ai duhet të aspirojë një qëllim të atillë, sa që ta çojë atë në lartësi dhe imagjinata të paarritshme. Ata që ia kanë dhuruar zemrën botës, që ulen e ngrihen duke menduar vetëm për të, i kanë shfrytëzuar të gjitha kapitalet që i përkasin ahiretit për hir të saj dhe kështu janë të destinuar të shkojnë duar bosh për në amshim.

Mënyrat e sfidimit të bukurive joshëse të botës

Ajo që duhet bërë për të mos u mashtruar nga bukuritë tërheqëse të botës është të mbash marrëdhënie të forta me Allahun. Të vendosim në qendër të lutjeve tona, kërkimin e mbrojtjes, mbështetjes dhe ndihmës së Allahut dhe gjithmonë të themi: *“O Allah, mbushi zemrat tona me dëshirën për të takuar Ty”*. Kurrë nuk duhet të ndalemi së kërkuari që të na shtojë besimin, dorëzimin dhe mbështetjen tek Ai. Por nga ana tjetër ne duhet të jemi koshient se të gjitha këto përpjekje tonat përsëri nuk mjaftojnë që ne ta njohim, ta lavdërojmë, ta falenderojmë dhe ta adhurojmë ashtu si Ai e meriton. Ndoshta këto ndjenjat tona që tregojnë vogëlsinë, dobësinë, mjerimin, paaftësinë dhe cektësinë tonë në adhurim ndaj Tij do të shërbejnë që këtë boshllikun tonë ta mbushi Allahu me mëshirën e Tij ndaj nesh.

Nëse duam të arrijmë mëshirën e Allahut të Madhëruar në ahiret, duhet ta dëshirojmë dhe kërkojmë atë gjithmonë në këtë botë. Pasi të jemi të kompletuar me ndjenja të tilla, bota kurrë nuk do mund të na i imponojë bukuritë e saj sado joshëse të jenë ato për ne. Ne si besimtar i Allahut e përdorim botën si një mjet, si një rrugë, si një korridor për të arritur dhe takuar Allahun. Nëse e shikojmë botën kështu, bota, që në fakt është e pavlerë si qymyri apo pluhuri i dheut të saj, befas do të shndërrohet në rubin, kristal dhe diamante të vlefshme për neve.

Allahu na mundësoftë ti besojmë dhe ta adhurojmë Atë ashtu si Ai e meriton të adhurohet. Amin!

Perktheu: Tauland Bica



1

KRYETARI I KMSH MERR PJESË NË KONFERENËN E 34 NDËRKOMBËTARE TË KËSHILLIT TË LARTË TË ÇËSHTJEVE FETARE NË EGJIPT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në konferenën e 34 ndërkombëtare të Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare në Egjipt me temë “Hapësira Kibernetike dhe Mjetet Moderne të Diskursit Fetar - Ndërmjet Përdorimit Racional dhe Devijimit nga e Drejta”.

Kryetari Spahiu ndodhet në këtë konferencë me ftesë të posaçme të Shkëlqesisë së Tij, Muhamed Mukhtar Xhuma, Ministër i Egjiptit për Çështjet Fetare, konferencë e cila u zhvillua në datat 9-10 shtator, nën kujdesin e Shkëlqesisë së Tij Abdul-Fetah el-Sisi, President i Republikës.

Në këtë konferencë morën pjesë krerë fetarë, dijetarë, drejtues institucionesh fetare, studiues etj nga më shumë se gjashtëdhjetë vende të botës arabe dhe më gjerë.

Gjatë saj u trajtuan problematika mjaft aktuale dhe të rëndësishme të kohës sonë që kanë të bëjnë me fetvanë elektronike, hapësirën kibernetike fetare, mjetet jotradicionale të komunikimit dhe ndikimi i tyre në përcjelljen e mesazhit fetar, kurset dhe mësimet online, përdorimi i dëmshëm i hapësirës elektronike në fushën e predikimit islam dhe metodologjia e korrjimit të tij.





2

KRYETARI I KMSH ZHVILLOI NJË VIZITË KORTEZIE NË AMBASADËN E MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me datë 13.09.2023 zhvilloi një vizitë kortezie në Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, ku u prit nga ambasadori saudit z. Faisal Ghazi Hifdhi.

Kjo vizitë e kryetarit Spahiu vjen në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe konsolidimit të marrëdhënieve të forta dypalëshe që kanë karakterizuar deri më tani marrëdhënien ndërmjet KMSH-së dhe Ambasadës së Arabisë Saudite në Tiranë.

Gjatë kësaj vizite z. Spahiu shprehu mirnjohjen në emrin e tij personal dhe në emër të të gjithë besimtarëve për shërbimin dhe mbështetjen e pandërprerë për islamin dhe myslimanët në Shqipëri të ofruar nga Mbretëria e Arabisë Saudite dhe Ambasada e saj në vendin tonë.

3

VIZITË E DREJTORIT TË ZYRËS RAJONALE TË LIGËS SË BOTËS ISLAME (RABITA) NË BALLKAN

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në zyrën e tij, z. Abdullah al-Qari, Drejtor i Zyrës Rajonale të Ligës së Botës Islame (RABITA) në Ballkan.

Z. Spahiu vlerësoi marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe rolin e RABITA në promovimin e vlerave islame në rang botëror, si dhe ofroi gatishmëri të KMSH për forcimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve në shërbim të islamit dhe myslimanëve në vendin tonë dhe rajon.

Nga ana e tij, z. al-Qari, vlerësoi përpjekjet e vazhdueshme të KMSH në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve, duke shprehur mbështetjen e tij dhe të Ligës ndaj KMSH-së.

Më tej biseda u fokusua mbi zgjerimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme bashkëpunimi nëpërmjet planifikimit të firmosjes së një sërë marrëveshesh mirëkuptimi si dhe mbi projekte fetare me interes të përbashkët që pritet të zhvillohen së shpejti në vendin tonë pikërisht në kuadër të këtyre marrëveshjeve.





4

INAGUROHET XHAMIA UZNOVËS, BERAT

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga Myftiu i Beratit, z. Emirjon Vathaj dhe stafi i myftinisë, së bashku me Sekretarin e Parë të ambasadës së Kuvajtit, z. Adnan Alghunaim, Drejtorin për Ballkanin të shoqatës “Mirënjohja”, z. Mahmoud Al Najdi dhe Drejtori i Fondacionit “Mirënjohja”, z. Samed Shehu morën pjesë në inagurimin e xhamisë Uznovë/Berat.

Kryetari Spahiu falenderoi donatorët për mbështetjen që japin në ndërtimin e xhamive në Shqipëri dhe për bashkëpunimin e ngushtë me KMSH, si dhe vlerësoi bashkëpunimin me Fondacionin “Mirënjohja” ndër vite. Ai gjatë fjalës së tij vlerësoi gjithashtu edhe kontributin dhe përkushtimin e veçantë të myftiut Vathaj në mbarëvajtjen e punëve në myftini në shërbim të besimtarëve të Beratit.

Miqtë nga jashtë dhe Drejtori i Fondacionit “Mirënjohja” shprehën vlerësimet e tyre për bashkëpunimin me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë si për ndërtimin e xhamisë në fjalë, por edhe për bashkëpunimet në të shkuarën.

Sekretari i Parë i Ambasadës së Kuvajtit tha gjatë fjalës së tij se investimet kuvajtiane në Shqipëri do të vijojnë të jenë të pranishme edhe në vijim.

Myftiu i Beratit, z. Vathaj, falenderoi donatorët për mbështetjen dhe tha se kjo do të jetë një xhami dinjitoze për banorët e zonës.





5

LIDERËT E KËSHILLAVE NDËRFETARË TË EVROPËS ZHVILLUAN NJË VIZITË NË SELINË E KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË

Liderët e Këshillave Ndërfetarë të Evropës zhvilluan një vizitë në selinë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku u pritën nga kryetari, H. Bujar Spahiu dhe drejtori i Kulturës z. Dorian Demetja.

Delegacioni evropian kryesohej nga Presidenti i Këshillave Ndërfetar të Evropës (RFP Europe) Dr. Luigi de Salvia dhe përbëhej nga presidentët dhe drejtuesit e këshillave ndërfetarë të Shqipërisë, Gjermanisë, Bullgarisë, Britanisë së Madhe, Hollandës, Spanjës, Italisë dhe Belgjikës.

Pasi ju uroi mirëseardhjen të pranishmëve, kryetari Spahiu, i falenderoi ata që zgjodhën Shqipërinë për të zhvilluar mbledhjen e tyre vjetore. Më tej, ai u ndal në një rezymë të shkurtër rreth Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, institucioneve në varësi të tij si dhe kontributit në promovimin e vlerave universale dhe dialogut ndërfetar në shoqërinë tonë.

Ndërsa, Dr. Luigi de Salvia, vlerësoi punën dhe bashkëpunimin e komuniteteve fetare në Shqipëri si një model për t'u eksportuar edhe në vendet e tjera të Evropës dhe më gjerë. Sipas tij, kjo ishte pikërisht edhe arsyeja se përse mbledhja e radhës së Këshillit Ndërfetar të Evropës u vendos që të zhvillohej në vendin tonë.

Delegacioni i lartpërmendur shoqërohej gjatë kësaj vizite në KMSH nga Prof. Genti Kruja, zv/president i Këshillave Ndërfetarë të Evropës dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë.



Kur feja mësuesit në shkollë



Me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me themelimin e shtetit të pavarur shqiptar, çështjes së zhvillimit të arsimit iu kushtua rëndësi kryesore. Në gazetën e Qeverisë së Vlorës shkruhej se: "Vetëm me një lërim të shëndoshë e me një arsim të vërtetë mund të ngjallet e mund të mëkëmbet kombi ynë e mund të fitojë të drejtën për të hyrë në radhët e popujve të qytetëruar". Sipas mundësive që pati Ministria e Arsimit, në vitin shkollor 1913-1914, çeli 46 shkolla fillore dhe dy normale përgatitore për viset që ishin të lira.

Në funksion të forcimit të unitetit kombëtar, Qeveria e Vlorës u përpoq të ndiqte një politikë ekuilibruese dhe afruese me të gjitha komunitetet fetare. Kjo vihet re edhe me faktin se disa klerikë të njohur të asaj kohe, siç ishte Haxhi Vehbi Dibra dhe Dom Nikoll Kaçorri mbanin detyra të rëndësishme në kabinetin e Ismail Qemalit. Në ato pak shkolla që u hapën nga Qeveria e Vlorës, krahas lëndëve shkencore, ekzistonte edhe një numër i kufizuar i lëndëve fetare. Për vetë mentalitetin e kohës dhe për një shtet të sapodalë nga një perandori teokratike, prania e lëndës së mësim-besimit ishte diçka normale.

Vitet e Luftës së Parë Botërore përbëjnë një nga periudhat më të ndërlikuara të historisë së Shqipërisë. Territori i vendit tonë u shndërrua në shesh luftimi për të dyja blloqet ndërluftuese dhe u nda në tri zona pushtimi: austro-hungarez, italian dhe francez. Në kuadër të interesave strategjike për forcimin e elementit shqiptar, Komanda Ushtarake Austro-Hungareze, e cila kishte pushtuar një pjesë të Shqipërisë së Mesme dhe atë të Veriut, mori masa për ngritjen e një administrate vendase duke krijuar tre drejtori: Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit me drejtor Luigj Gurakuqin, Drejtorinë e Financave me drejtor Fejzi Alizotin dhe Drejtorinë e Drejtësisë me drejtor Avni Dabullën. Ajo që vlen për t'u theksuar është se përgjatë kësaj periudhe u hapën një numër i madh shkollash shqipe dhe u hartuan disa nga programet më të rëndësishme për historinë e shkollës dhe mendimit pedagogjik shqiptar, si: Organizimi i përkohshëm i shkollave shqipe, 20 shtator 1916; Programi i mësimëve për pesë rendet e shkollave fillore shqipe, 18 tetor 1916; Përparimi i arsimit shqiptar, 26 janar 1918, etj. Në të gjitha programet mësimore të këtyre shkollave lënda e besimit fetar, për t'u zhvilluar dhe për t'u shpërndarë sipas klasave, i ishte lënë në dorë komuniteteve fetare. Sipas planit mësimor kjo lëndë zinte tre orë në javë për tri vitet e para dhe dy orë në javë për vitin e katërt dhe të pestë.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, më 21 janar 1920, u mbajt Kongresi Kombëtar i Lushnjës, i cili mori vendime shumë të rëndësishme për shpëtimin e Shqipërisë dhe për bashkimin kombëtar. Qeveria e dalë nga ky kongres i kushtoi një rëndësi të veçantë zhvillimit të arsimit. Në këtë kuadër, Ministria e Arsimit, më 15 gusht 1920, thirri kongresin arsimor të Lushnjës, ku morën pjesë disa nga arsimtarët më të njohur të vendit tonë. Lidhur me zhvillimin e lëndëve fetare nëpër shkollat shqiptare, Kongresi Arsimor

i Lushnjës vendosi që programet dhe orët e mësimi të besimit t'u lireshin autoriteteve të secilës fe, ndërsa të drejtën e kontrollit për zbatimin e këtyre orëve duhet ta kishte Ministria e Arsimit.

Më 4 nëntor 1920, Ministria e Arsimit njoftoi Këshillin e Naltë të Sheriatit për të mbledhur një komision të posaçëm, i cili do të merrej me shqyrtimin e pyetjeve që dilnin lidhur me përcaktimin e lëndës së besimit në arsimin publik. Pikat kryesore që do të diskutoheshin në këtë takim ishin: caktimi i orëve të mësim-besimit nëpër shkollat që frekuentoheshin nga myslimanët, shkollat e katundeve, në shkollat fillore, në shkollat qytetëse dhe normale; programet analitike që do të shërbenin si manual për autorët që do të hartonin librat e besimit mysliman; dhe se ç'rregull duhet të ndiqnin shkollat publike në muajin e Ramazanit për vazhdimin e mësimi të nxënësve. Me gjithë këto lëshime, shteti i ri shqiptar nuk miratoi asnjë fe zyrtare dhe shpalli se ndiqte një politikë laike në marrëdhëniet me bashkësitë dhe praktikat fetare të popullsisë. Kjo u bë me qëllim për të forcuar lidhjen kombëtare midis shqiptarëve të tri besimeve fetare. Për pasojë, shteti laik e shpallte veten si agjentin veprues të kombit dhe në emër të njësimi kombëtar, ai ushtronte kontroll të rreptë mbi çështjet dhe organizatat fetare. Kjo u vu re më së miri në orientimin që u ndoq për organizimin e sistemit arsimor, ku si shembull u mor kryesisht Franca, e cila njihej për konsekuencën që ndiqte për laicizimin e institucioneve publike. Kështu, më 7 janar 1921, ministri i Arsimit i drejtoi kryeministrit një shkresë me anë të së cilës shprehte nevojën që ky dikaster kishte për modelet e sistemeve të ndryshme arsimore që aplikoheshin nga kombet e qytetëruara. Ai kërkoi gjithashtu që të urdhërohej kryesekretari i Ministrisë së Jashtme, Nuri Vila, i cili ato ditë ndodhej në Paris, që t'i dërgonte kësaj ministrie programet, rregulloret dhe ligjet e arsimit fillor dhe të cikleve të tjera shkollore, si dhe nga tre ekzemplarë autorësh të ndryshëm për çdo libër që përdorej nëpër shkollat fillore të Francës. Kjo ministri sugjeronte gjithashtu që një urdhëresë e tillë t'i jepej edhe kryetarit të delegacionit shqiptar në Gjenevë, Fan Nolit, që edhe ai të dërgonte të njëjtat programe, rregullore dhe ligje arsimore që përdorreshin në kantonet e Zvicrës. Një fakt i tillë tregon se drejtuesit e Ministrisë së Arsimit ishin të prirur të merrnin si shembull vendet më të përparuara.

Duke u mbështetur në të drejtën e njohur më parë nga vetë shteti shqiptar, në muajt e parë të vitit 1921, Gjyqi i Naltë i Sheriatit i kërkoi Ministrisë së Arsimit që të drejtën e inspektimit të lëndës së besimit në shkolla, ta merrte përsipër ky institucion. Një kërkese e tillë ky dikaster iu përgjigj në mënyrë kategorike, duke shkruar se në këtë fushë ende nuk kishte ndonjë ligj të veçantë, sipas të cilit do të mund të rregullohej kjo çështje; inspektimi i mësimi të fesë për të tre besimet do të zgjidhej pasi të bëhej një ligj i posaçëm. Prandaj, një inspektim i tillë së bashku me shqyrtimin e librave që do të përdorreshin për këtë lëndë nuk mund të lejohej. Sipas ministrit të Arsimit, Rexhep Mitrovica, i cili njihej për pikëpamjet e tij ekstremisht laike, kjo ishte një

e drejtë legjitime dhe ekskluzivitet i këtij dikasteri.

Ndërkohë nga masat e gjera të popullsisë çdo ditë e më shumë po shfaqej një pakënaqësi e përgjithshme. Ankesës së Gjuqit të Naltë të Sheriatit mbi problemet që ishin hasur në Prefekturën e Korçës dhe Gjirokastrës, Ministria e Arsimit iu përgjigj se sipas raporteve që kishte marrë nga drejtoritë arsimore të këtyre rretheve, mësimi i besimit si për myslimanët, ashtu edhe për të krishterët jepej rregullisht nëpër shkollat e këtyre prefekturave. Kjo lëndë me vendim të këshillave arsimore u ishte ngarkuar mësuesve të gjuhës, duke u caktuar edhe orët përkatëse. Në ato shkolla ku kishte nxënës të përzier, për të dhënë mësimin e fesë ishin emëruar dhe po emëroheshin mësues të veçantë. Meqenëse ky mësim jepej sipas statutit të atyre prefekturave, ministri i Arsimit shkruante se nuk mund t'i kundërshtonte në asnjë mënyrë. Ai e kishte princip që mësimi i fesë të lihej i lirë e të mësohej në çdo prefekturë e nënprefekturë sipas vullnetit e dëshirës së popullit. Si rezultat i presionit të krijuar dhe për të vendosur ekuilibrat e brendshëm, në një situatë politike ende të pastabilizuar për shtetin e ri shqiptar, kryeministri Iliaz Vrioni urdhëroi Ministrinë e Arsimit që të tregohet më e kujdesshme. Ministri i Arsimit, i revoltuar nga këto ankesa, iu përgjigj kryeministrit se që nga Kongresi Arsimor i Lushnjës programet dhe orët e mësimit të feve iu ishin lënë autoriteteve të secilës fe, ndërsa të drejtën e kontrollit për zbatimin e këtyre orëve e kishte kjo ministri. Ministri ankohej gjithashtu edhe ndaj ndërhyrjeve të Ministrisë së Brendshme, e cila, e interesuar për të ruajtur qetësinë publike dhe për të evituar mundësinë e shfrytëzimit të këtyre rasteve nga ndonjë shtet i huaj, kishte urdhëruar prefekturat dhe nënprefekturat nën varësi të saj, që të ndërhyjnë menjëherë pranë shkollave për zbatimin e programit të mësim-besimit.

Përballë një situatë të tillë, Ministria e Arsimit kërkoi ngritjen e një komisioni, i cili do të merrej me çështjen e hartimit të programit të lëndës së mësim-besimit. Në këtë komision, që u mbledh për herë të parë më 16 shtator 1921, bënin pjesë figura eminente të klerit dhe intelektualë të njohur myslimanë, si: Hafiz Ali Korça, Sali Vuçiterni, Hafiz Ibrahim Dalliu, Halit Rroji, Sali Çeka, Hysen Myshketa, S. Ndroqi, Sulejman Kadiu, etj., të kryesuar nga Hoxha Kadriu. Komisioni vendosi që lënda e besimit mysliman të ndahej në mënyrë të veçantë për shkollat fillore, qytetase dhe të mesme, duke marrë parasysh metodat pedagogjike bashkëkohore. Sipas propozimit të Komisionit dhe pëlqimit nga ana e Ministrisë së Arsimit, u vendos hapja e një kursi gjashtëmuor në qytetin e Shkodrës, që do të përgatiste mësues të pajisur me aftësi profesionale për dhënien e lëndës së mësim-besimit në shkollat shtetërore.

Për shkollat fillore që përfshinin moshën 7-12 vjeç, sipas programit të mësipërm, nxënësi do të mësonte të lexonte Kur'an dhe Ilmihalin, duke marrë parasysh normat bashkëkohore të pedagogjisë.

Për rendin e I do të kishte vetëm gjëra praktike me gojë

e jo me shkrim.

Në rendin e II do të mësohej Abetarja Shqip dhe do të fillonin shkronjat arabe sipas metodës përkatëse, ndërsa në rendin e III do të fillonte këndimi i Kur'anit dhe Ilmihalit.

Në rendin e IV-V të fillores do të mësohej historia islame në mënyrë graduale dhe një pjesë e vogël e Texhvidit, që përfshin rregullat e leximit të Kur'anit.

Në mbledhjen e zhvilluar më 9 tetor 1921, Komisioni mori vendimin që orët e mësim-besimit të ndaheshin në këtë mënyrë: Në rendin e II të fillores mësim-besimi të bëhej 3 orë në javë, ku çdo orë do të kishte dy lëndë mësimi nga një gjysmë ore secila.

Edhe në rendin e III, të IV e të V nga 3 orë në javë. Në këtë mënyrë do të merrte fund edhe problemi i mësim-besimit në shkollat fillore.

Tabela 1

Mësim-besimi në shkollat fillore (1921)

Klasa Orë në javë

I	-
II	3
III	3
IV	3
V	3

Tabela 2

Mësim-besimi në shkollat qytetëse

Klasa Orë në javë

I	3
II	2
III	2

Tabela 3

Mësim-besimi në shkollat normale

Klasa Orë në javë

I	3
II	3
III	3
IV	3
V	3

Tabela 4

Mësim-besimi në gjimnaze

Klasa Orë në javë

I	2
II	2
III	3
IV	2
V	2

Për hartimin e librave të mësim-besimit u vendos krijimi i një komisioni të veçantë, pjesë e të cilit ishin Hoxha Kadri Prishtina, Hafiz Ali Korça, Sali Vuçiterni, Sulejman Kadiu dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Salih Çeka.

Në bazë të vendimeve të marra nga Kongresi Pedagogjik i Lushnjës, më 18 korrik 1920, për sa i përket ditëve të pushimit në shkollat shtetërore, krahas ditëve të pushimit

me karakter kombëtar ose të besimeve të tjera fetare, për nxënësit myslimanë konsideroheshin si ditë pushimi festat e mëposhtme: 2 ditë para Bajramit të Ramazanit, 5 ditë me rastin e Kurban Bajramit, 3 ditë me rastin e Bajramit të Ramazanit, 1 ditë me rastin e Mevludit dhe nga 1 ditë me rastin e netëve të mira.

Tabela 5

Ditët e pushimit për nxënësit myslimanë

Festa Nr. i ditëve

Dy ditë para Bajramit të Ramazanit	2
Bajrami i Ramazanit	3
Kurban Bajrami	5
Mevludi	1
Nata e Regaibit	1
Nata e Miraxhit	1
Nata e Beraetit	1
Nata e Kadrit	1
Dita e Nevruzit	1
Gjithsej	16

Me gjithë përpjekjet për gjetjen e ekuilibrave të nevojshme midis Ministrisë së Arsimit nga njëra anë dhe popullit mysliman e Gjuqit të Naltë të Sheriatit nga ana tjetër, pati edhe keqkuptime, të cilat erdhën kryesisht nga masat e pamatura dhe të nxituara për kohën të ministrit të Arsimit Rexhep Mitrovica. Kulmi i këtyre keqkuptimeve arriti në vitin 1922, kur pas ankesave të popullsisë së Shkodrës, me anë të një shkrese ai i drejtohej kryeministrit me fjalët: "Një anomali të madhe jemi tue pamë në Ministrin tonë, megjithëse qeveria jonë quhet e thirret afetare ne jemi tue mbajtur, sidomos ndër shkolla t'anës së veriut, mësimin e besimit e tue prishun shuma bukur të forta në mënyrë që Ministria jonë mund të thuhet se asht fetare, punë që i kundërshton parimit që ka marrë për themel Qeverija". Një ballafaqim të njëjtë, tani jo për çështjen e lëndës së mësim-besimit, e cila sipas pretendimeve të klerit dhe popullsisë myslimane nuk zbatohej me përpikëri nëpër shkollat shqiptare, por për hapjen e gjimnazit në Shkodër, Rexhep Mitrovica pati edhe me klerin katolik. Kjo, sepse ky i fundit e shihte këtë si një rrezik të monopolizimit të arsimit nga shteti. Kleriku P. Ambroz Marlaskaj u përpoq të tregojë në broshurën Nji monument pazotsije në lamë të arësimit në Shqipni, Shkodër, 1922, se gjimnazi do të ndiqej vetëm nga nxënësit myslimanë.

Me kalimin e kohës, orët e mësim-besimit në shkollat shtetërore erdhën duke u reduktuar. Kjo shkaktoi pakënaqësi në radhët e klerit mysliman. Më 16 nëntor 1924, me një vendim të posaçëm, Këshilli i Naltë i Sheriatit e kontestoi qarkoren e Ministrisë së Arsimit, datë 24 shtator 1924, e cila urdhëronte drejtoritë arsimore në çdo prefekturë që:

1) Mësimi i besimit të bëhej dy orë në javë, në klasat e fundit, në orët e fundit, paradite ose pasdite.

2) Mësimi i besimit të bëhej prej trupit mësimor sipas fesë. Në rast të mungesës së personelit, mësimi i fesë përkatëse do të rekomandohej prej autoritetit përkatës fetar, i cili do të merrte përsipër edhe pagimin e rrogës së tij.

3) Ministria e Arsimit e shihte si të domosdoshme që

mësuesit e secilit besim fetar të ishin në pajtim me kërkesat shtetërore e njerëzore, që shkolla të rriste dhe të edukonte fëmijë, vëllezër, etj. Ndryshimi në fe nuk i pengonte shqiptarët të ishin shtetas të mirë dhe atdhetarë të ndershëm.

Nga të gjitha këto pika, Këshilli i Naltë i Sheriatit më shumë të arsyeshme shihte pikën tre, meqenëse mësimet e fesë islame nuk binin në kundërshtim me këtë pikë. Por, ky Këshill kërkoi nga Ministria e Arsimit sigurimin e zhvillimit të mësim-besimit nga mësues të aftë; kompetenca e dhënies së mësim-besimit të caktohej nga autoritetet fetare; të ngarkoheshin autoritetet fetare për të mbikëqyruar dhënien e mësim besimit; mësim-besimi të ishte një lëndë e detyrueshme ashtu sikurse lëndët e tjera; kjo lëndë të ishte pengesë për të kaluar klasën, nëse nxënësit nuk tregonin zotësinë e duhur mbi mësim-besimin në kohën e provimit; rrogat e mësuesve të mësim-besimit të paguheshin nga arka e shtetit, si mësuesit e tjerë; mësim-besimi i nxënësve myslimanë të zhvillohej sipas programit analitik, i përgatitur nga një komision i posaçëm që i ishte paraqitur Ministrisë së Arsimit me anë të shkresave 640/II, 640/III datë 19.11.1924 dhe 11.10.1921 dhe 11.9.1921 nga ana e Kryemyftiut të Shqipërisë.

Pikëpamjet mbi laicizimin dhe kombëtarizimin e shkollës shqiptare, ministri i Arsimit Rexhep Mitrovica, i shpjegoi në mënyrën më sintetike në një numër të posaçëm të "Revistës Pedagogjike" me titull "Letër e dytë Arsimitarëve të Shqipnis". Ndër të tjera ai justifikohet se personalisht nuk ishte kundër besimeve fetare; se ishte plotësisht e vërtetë se një ndër mjetet për të formuar njerëz të ndershëm ishte mësimi i besimit dhe ai i moralit. Por, gjithsesi, ai i përmbahej parimit se: "Shkolla popullore duhet të ishte një shkollë asnjënjëse, por jo me indiferencën e saj për ndjesit fetare, mbasi ajo është shkollë kombëtare, shkollë e një kombi ku nënshtetasit janë mbështetur në ndjenja fetare të ndryshme. Shkolla do t'a respektojë këtë ndjesi fetare, do të kujdeset fort e të ruhet që të mos i nisë pa kohë nxënësit e vegjël të shkollës fillore ndër pasione që nuk i përshtaten moshës së tyre".


Pavarësisht këtyre mendimeve, që siç e kemi theksuar dhe më sipër ishin disi të nxituara për kohën, në raport me mentalitetin, por edhe me reformat arsimore të ndjekura nga shtetet më të civilizuar të Evropës, Rexhep Mitrovica mbetet një figurë me një kontribut të rëndësishëm në fushën e arsimit kombëtar.

Në shkollat shqiptare lënda e mësim-besimit vazhdoi të jepej edhe më vonë. Por tani vetëm në shkollat fillore dhe në mënyrë më të reduktuar sesa periudha e marrë në shqyrtim nga ana jonë.

**Dr. Hasan Bello
Studiues, Instituti i Historisë - Tiranë**

ALTERNATIVAT E KAMATËS NË FINANCIMIN E KAPITALIT TË SIPËRMARRJEVE

Një këndvështrim juridik i organizimit të biznesit në Islam



Fuqia e një shoqërie dhe potencialet e saj varen nga aftësia e vet për të përmbushur nevojat e anëtarëve të saj me të mira dhe shërbime. Prodhimi dhe shpërndarja e këtyre të mirave dhe shërbimeve pa dyshim që kërkon resurse jo vetëm financiare, por edhe menaxheriale. Prandaj ato duhen alokuar në mënyrë që të përmbushen nevojat e shoqërisë. Duke ditur se kreditë me interes dhe obligacionet janë të ndaluara nga Islami, atëherë alokimi duhet të bëhet në mënyrë të organizuar dhe i ngritur mbi baza drejtësie dhe altruizmi, siç e kërkon feja. Por si mund të ngrihet kjo pa futur në mes kamatën dhe interesat e ndryshme financiare?

Së pari, shtetëzimi apo privatizimi. Qeveria apo shteti duhet të ndërmarrë një rol administrativ efikas duke dhënë me koncesione –pra fitimprurëse– asetet e ndryshme publike, në mënyrë që këto të bëhen rentabël qoftë për biznesin privat, apo qoftë për shtetin nga taksat që vjel. Nëse shteti mund të menaxhojë vetë më mirë disa sektorë të aseteve të tij siç janë minierat, nafta, etj., atëherë do të ishte në të mirën publike që ai ta bënte vetë këtë sipërmarrje, pasi fitimi do të ishte shumë herë më i lartë sesa dhënia me koncesion e më pas vjelja e taksave prej kontraktorëve. Pra, siç e shikojmë, në të dy rastet jemi në marrëdhënien fitim-humbje siç e kërkon Islami e jo në atë të shfrytëzimit siç është në rastin e kamatës.

Së dyti, Financimi kapitalit. Një numër i madh i bizneseve aplikon sistemin e financave islame në financimin e kapitaleve të tyre. Si është kjo formë? Financuesi kontribuon me pjesën e vet të fondit dhe në bazë të peshës specifike të dhënë, ai mbart humbjen ose fitimin. Kështu kemi një shpërndarje të riskut e të fitimit tek të gjithë ortakët. Ndryshe nga ç'ndodh në rastin e kredive me interes (kamata), ku debitori duhet të mbajë të gjithë barrën e borxhit dhe riskun e falimentit. Në këtë mënyrë rritet edhe efënca e administrimit të sipërmarrjes, pasi ortakët do mbikëqyrin aktivitetin dhe ecurinë e sipërmarrjes, siç ndodh në Amerikë, dhe nuk do e lënë atë në dorë të dikujt, siç është rasti i bankave ku përgjithësisht ekzagjerohet me shifrat e bilanceve, por edhe nëse ato janë reale, përsëri ecuria e biznesit nuk është e sigurt.

KANALET E FINANCIMIT

Kanalet e investimit janë tre: njëortakëria, shumëortakëria dhe shoqëritë aksionare.

a- Njëortakëria

Këtu biznesi mbetet vetëm i pronarit fillestar edhe pas financimit të financuesit. Një formë e kësaj mund të jenë edhe blerësit nesieh (me mall). Pra, në rastin kur klienti e blen mallin te distributori me një çmim më të lartë në të ardhmen. Këtu nuk kemi të bëjmë me një kredi me interes, por me një shitblerje për çmimin e së cilës bihet dakord në avancë. Kjo është njëra formë. Forma e dytë ka të bëjë me marrjen hua te distributori të mallrave pa interes e, më pas, pasi të qarkullohet malli, atëherë atij i kthehet principli. Interesi distributorit në këtë rast është shtimi i shitjeve.

Duhet thënë se kjo praktikë ndodh rëndom në jetën e përditshme.

Shembulli i mësipërm ishte ai i financimit me mall nga distributori, kurse financimi me likuiditet mund të ndodhë duke kërkuar, fjala bie, që të financohet një kargo apo një furnizim i caktuar dhe për të –jo për gjithë biznesin, financuesi bëhet pronar në atë masë që bihet dakord e, për rrjedhojë, pasi të zhvishet nga gjitha shpenzimet, mund të marrë përqindjen e fitimit që i takon. Kjo në rast se rezultati është pozitiv, në të kundërt, ai duhet të mbajë përsipër riskun e humbjes. (Kjo formë quhet mudarabe). Nëse edhe kjo formë nuk i mjafton një subjekti për të financuar biznesin e tij, atëherë mund të inkorporojë të tjerë financues të cilët bëhen automatikisht ortakë në të (musharakeh).

b- Shumëortakëria (Partnershipi)

Partnershipi në Islam ndahet në dy kategori: Mudarabe dhe Musharakeh

1- Mudarabe është një formë organizimi i njohur nga ligjet e fesë, e cila nënkupton se personi i cili paraqet një projekt të caktuar ngarkohet me menaxhimin e saj, duke ndarë kështu fitimin me investitorët në bazë të ndarjes së rënë dakord. Pra, personi si ekspert i punës investon diturinë dhe energjitë e tij, kurse financuesit kapitalin. Kjo formë njihet edhe sot si fushata ku agjentët e marketingut vlerësohen me përqindje fitimi e jo me pagë fikse. Thënë ndryshe, financuesit marrin në fund përqindjen e fitimit e jo kthimin e borxhit + kamatën, siç është rasti i kredive financiare konvencionale me kamatë. Nëse marrëveshja lidhet me disa mallra të caktuar, apo me disa projekte të caktuara, apo lidhet vetëm për një kohë të caktuar, ato përfundojnë me përfundimin e kushteve të rëna dakord. Nëse janë pa afat, ato mbeten në fuqi. Duhet theksuar se administratori apo personi i ngarkuar për të administruar biznesin, nuk i lejohet të marrë pagë mujore apo vlerësim të caktuar, pasi përndryshe do të hynte nën kategoritë e kamatës. Puna e tij është "investimi" që ai i ka dhënë kompanisë, për rrjedhojë nuk lejohet të marrë si kundraparti të kësaj shpërbllim. Shembull i këtij lloji biznesi sot mund të jenë bizneset e vogla artizanale apo bujqit e vetëpunësuar, të cilët njëkohësisht janë edhe ekspertët që e gjallërojnë biznesin.

2- Musharakeh është po ashtu një nga organizimet e njohura fetarisht nga ku dy apo më shumë individë financojnë dhe administrojnë njëkohësisht sipërmarrjen. Rrjedhimisht fitimet ose humbjet i ndajnë në bazë të dakortësisë apo në bazë të kapitalit të investuar.

3- Format e përziera midis ortakut të vetëm, mudarabes dhe musharakes. Bëhet fjalë kur investitorët nuk kanë mundësi të menaxhojnë projektet apo nuk kanë dëshirë të merren me këtë, por thjesht të diversifikojnë portofolin e tyre, duke investuar në sektorë të ndryshëm rentabël. Kështu ata mund të financojnë disa projekte të caktuara duke u bërë ortak në riskun e humbjes apo fitimit të tyre. Këta quhen ortakë të fjetur dhe mund të ngarkojnë dikë tjetër për t'u marrë me investimet e tyre.

c- Shoqëritë aksionare

Shoqëritë aksionare janë institucione financiare dhe konsiderohen si më të përshtatshmet për investim. Ato janë forma më e vulltshme për diversifikimin e portofolit sot në botë. Ata janë investitorë që nuk kanë projekte konkrete e as kanë dëshirë të bëhen ortakë në biznes, por thjesht duan të investojnë në shoqëri të ndryshme aksionare dhe në fund të korris fitimin. Financimi korporatave me aksione e jo me kredi, ndihmon në eliminimin e mundësisë së ngritjes të një superstrukture financiare të fryrë, siç zakonisht ato ngrihen formën e një piramide vice-versa dhe të cilën zakonisht e ushqen sistemi financiar me kredi.

Në një raport mbi Japoninë të publikuar në The Economist më 25 shkurt, 1978, f. 97, thuhej se kompania Eidaï - *një prodhues i lartë kompesatash në Japoni* - kishte borxhe që kapnin shifrën e 1 miliard \$, ndërkohë që kapitali i paguar ishte vetëm 32 milion \$. Pa dyshim që ky është një rast ekstrem, mirëpo edhe nëse rastet e tjera janë në kushte më të favorshme, sërish indukojmë se spiralla e kredive me kamata është vobull e cila, nëse përfshihesh në të, të involvon gjithmonë e më shumë në gropën e borxheve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës fondet prej 178.9 bilion \$ ishin financuar nga sektori bankar, vetëm 10 miliard \$ ose 5.6 për qind ishte nga kapitali i investuar (shih Buletinin e Rezervës Federale, janar 1978, Tabela A44). Siç e shohim, edhe shtetet më të industrializuara nuk ia kanë arritur dot që t'i shpëtojnë efekteve negative të kredive me interes.

Financimi me pjesëmarrje ndihmon në parashtrimin e parimit të përhapjes së ortakërisë së projekteve dhe ndihmon në një masë të madhe në realizimin e objektivit të shpërndarjes së drejtë të të ardhurave dhe pasurive. Megjithatë, vërehet që me përhapjen e pronësisë në një rrafsh të gjerë, shumë nga investitorët e vegjël nuk marrin dot pjesë në procesin e vendimmarrjes. Kjo nga ana e saj çon në përqendrimin e pushtetit tek një dorë e vogël njerëzish për projekte madhore. Por këto efekte janë fare të papërfillshme krahasuar me efektet negative që trashëgojnë kreditë me interes.

Financimi i kapitalit me pjesëmarrje ndihmon në reduktimin e diskriminimit në huadhënie midis qeverisë dhe sektorit privat njëkohësisht. Kjo sepse mendohet që sektori publik ka risk afër zeros në faliment apo në moskthim borxhi. Pra bankat nuk derdhin mund të mjaftueshëm në vlerësimin e qëllimit për të cilin do përdoret huaja, për rrjedhojë mund të shpjerë në një analizë jo objektive nga oficerët e kredisë së riskut të falimentit të biznesit siç ndodh rëndom.

Sot në Shqipëri borxhet e këqija të bankave janë diku te 27%, pra gati 1/3 e borxheve. Kjo butafori vazhdon deri në momentin që banka falimenton dhe zbardhen faktet, siç ishte rasti i kolapsit të Penn Square Bank, apo skandali bankës Ambrosiano në Itali, problemet e Herstatt Bank në West Germany, apo vështirësitë e bankave të ndryshme në vende të tjera të globit.

Një shembull për këtë pjesë do të ishte skenari i borxhit publik të Meksikës që kishte kapur shifrën e 80 miliardë \$,

60 miliardë \$ prej tyre ishte borxh i marrë hua nga bankat, 49 % të borxhit bankës 60 miliardë \$, duhej paguar brenda një viti. Maturimi si dhe shkalla e lartë e borxhit të Meksikës ishte problem. Kriza e likuiditetit të Meksikës, e cila kishte arritur një proporcion më të madh sesa vetë sistemi financiar i saj, do t'i kishte çuar bankat më të mëdha ndërkombëtare në kolaps, nëse nuk do të ishte gjetur zgjidhja në momentin e fundit. Bankat kreditore të Meksikës nuk kishin zgjidhje tjetër vetëm se të binin dakord me kërkesën e vendit për ristrukturimin e borxhit dhe madje edhe për të dhënë edhe më shumë hua. Disa qeveri dhe institucione ndërkombëtare dhanë gjithashtu burime financiare për të mundësuar Meksikën që të vazhdonte pagesat e interesit të cilat përndryshe nuk do të kishte qenë në gjendje t'i likuidonte. Meksika sigurisht nuk është e vetmja viktimë në historinë e huave me interes, Greqia është një tjetër rast që po përballet me fatin e Meksikës aktualisht.

KOOPERIMI

Përveç formave të mësipërmeve të organizimeve ligjore shëriatike, ka dhe forma të tjera të cilat janë fitimprurëse. Krahas shpërblimit ato synojnë të japin një kontribut të çmuar në realizimin e objektivave islame. Me nxitjen që Islami i bën vëllazërimit, bashkëpunimi në forma të ndryshme për të zgjidhur problemet e përbashkëta për prodhuesit, tregtarët dhe konsumatorët, atyre që kanë kursime me një anë dhe atyre që kërkojnë fonde për të financuar bizneset e tyre, përcaktohet që të ketë një rëndësi të veçantë në shoqërinë islame. Ndërsa themi se orientimi i projekteve në ekonomiksën islam është i vogël apo i mesëm për nga forma, kooperimi ndihmon në realizimin e prurjeve të mëdha.

Korporatat kanë mundësi që t'u ofrojnë anëtarëve të tyre shumë shërbime të dobishme, si për shembull: të ardhura për të bërë blerje apo shitje në sasi të mëdha, lehtësira në mirëmbajtje dhe shërbime direkte në zgjidhjen e problemeve administrative dhe teknike, si dhe sigurimi të përbashkët.

Bashkëpunimi tolerant (*i pa kodifikuar*) joformal midis zejtarëve e bujqve nga njëra anë dhe tregtarëve nga ana tjetër, ka qenë tepër i përhapur përgjatë historisë islame dhe ka marrë forma të ndryshme si për shembull: sindikatat, IBDA (dhurimi i gjithë mallit në formën e biznesit social) etj.

Këto forma të ndryshme nuk shprehën vetëm vëllazëri islame e besim reciprok, por zgjidhën shumë probleme të përbashkëta midis biznesmenëve mbi baza reciprociteti dhe suporti. Jodovitch shkon deri aty sa e konsideron IBDA-në jo vetëm një shërbim tregtar, por "Vepër tregtare sistematike, që e hasim shumë kur kërkojmë për sipërmarrjet, depozitat, garancitë dhe dorëzanitë".

Këto ishin disa nga format më të përhapura të financimit të kapitalit sipas normave islame, të cilat e ruajnë të shëndoshë biznesin, ndryshe nga praktikat konvencionale të sistemeve financiare.

Enklid Pelari



Gusuli te gratë



Farzet e gusulit

Gusuli është: "Larja e të gjithë trupit në një mënyrë të veçantë". Gusuli është bërë detyrim nëpërmjet një ajeti Kur'anor ku thuhet:

أَوْرَةَ طَافَ ابْنُ مَرْثَدٍ نِوِ

"Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)."

Sipas medh'hebit Hanefi, farzet e gusulit janë tre:

- 1-Larja e gojës tre herë duke bërë gargarë (madmada)
- 2-Larja e hundës tre herë duke e tërhequr ujin deri sa hunda të ndjejë djegie të lehtë brenda saj (istinshak)
- 3-Larja e të gjithë trupit në një mënyrë që mos të mbesë në të asnjë pjesë e thatë.

Farzet e gusulit sipas medh'hebit Shafii gjithashtu janë tre:

- 1-Nijeti (qëllimi i thënë me gojë dhe me zemër).
- 2-Pastrimi i papastërtisë që gjendet në trup (nëse ka).
- 3-Larja e të gjithë trupit.

Farzet e medh'hebit Hanefi që janë madmada dhe istinshak, janë cilësuar si synnete në medh'hebin Shafii. Ndërsa nijeti, i cilësuar si farz në medh'hebin Shafii, cilësohet si synnet në medh'hebin Hanefi.

Dobitë e gusulit janë të shumta por këtu mund të përmendim njëriën prej tyre. Gusuli i marrë pas kryerjes së marrëdhënieve bashkëshortore, pas asaj lodhjeje që e kaplon trupin, i përfiton trupit një energji të re, rifreskim, i stabilizon qarkullimin e gjakut dhe e përgatit njeriun për një atmosferë adhurimi.

Si merret gusuli?

Në fillim i gjithë trupi laget me ujë. Më pas pastrohen papastërtitë dhe pastrohen vendet si kërthiza dhe organet intime. Pas këtyre, merret abdest normal si abdesti për namaz dhe në fund lahet i gjithë trupi duke e fërkuar, për të mos mbetur asnjë pjesë e pa lagur. Duhet patur parasysh që gjatë marrjes së gusulit nuk duhet shpërdoruar me ujin. Për këtë arsye këshillohet që të merret gusul me ujin e përgatitur në kovë e jo me ujin që del nga çezma. Edhe nëse përdoret çezma, në këtë rast këshillohet që ajo mos të jetë e hapur në maksimum saqë të jetë i vështirë kontrolli i ujit dhe të mundësojë shpërdorimin e tij. Gjithashtu gjatë marrjes së gusulit është shumë i rëndësishëm fërkimi i trupit. Sipas jurisprudencës Maliki, fërkimi i lëkurës së trupit gjatë marrjes së gusulit, është farz. Megjithëse në jurisprudencën tonë Hanefi, fërkimi i trupit nuk cilësohet ndër farzet, pikëpamja e jurisprudencës Maliki, duhet të na ngjalli në brendësinë tonë ndjenjën se ky qenka një fakt i rëndësishëm dhe duhet ta kemi parasysh edhe ne gjatë gusulit.

A është e nevojshme që flokët e gërshetuara të zgjidhen kur merret gusul?

Nëse një grua në momentin që është bërë për të marrë gusul, i ka patur flokët gërshet dhe e ka të vështirë t'i zgjidhi ato, atëherë për të mos e vështirësuar atë është e mjaftueshme vetëm larja e flokëve duke depërtuar në mënyrë natyrale deri tek rrënjët në lëkurë. Në të kundërt, nëse uji nuk depërton dot deri në lëkurë, atëherë flokët duhet të zgjidhen. Por, nëse gruaja nuk i ka flokët e gërshetuara, në këtë rast ajo e ka farz (detyrim) larjen e të gjithë flokut deri në rrënjë ashtu siç është. Për sa i përket meshkujve, nëse i kanë flokët të gërshetuara, duhet t'i zgjidhin me patjetër. Për më tepër, floku i gjatë është stolisje dhe zbukurim për femrat

e jo për meshkujt. Të njëjtin opinion ka edhe jurisprudenca Shafii.

Nëse gruaja ka një arsye tjetër që nuk mund t'i zgjidhi flokët apo nuk mundet dot ta lajë kokën me ujë, për shembull në qoftë se ka një plagë, atëherë mundet vetëm të fërkojë kokën me dorën e lagur, pra të bëjë mes'h mbi flokët.

A duhen larë vrimëzat e shpuara nga vathët?

Praktikisht pas heqjes së vathëve nga veshët është e mjaftueshme vetëm spërkatja me ujë e vrimëzave dhe fërkimi me dorë i tyre, pa hyrë në vështirësi të tjera si, futja e një gjilpëre mes vendit të shpuar etj. Nëse vrimëzat e hapura, me kalimin e kohës janë mbyllur, atëherë nuk ka më nevojë për një larje të tillë.

A prihen thonjtë gjatë gjendjes xhunub?

Si fillim duhet të theksojmë se prerja e thonjve në gjendjen xhunub, nuk është haram (e ndaluar) pasi për këtë nuk ka asnjë argument kur'anor apo profetik. Ndërsa imam Gazaliu e ka trajtuar këtë pjesë më me kujdes duke vendosur pikëpamjen e tij se, meqënëse në ditën e gjykimit njeriu do të ringjallet edhe me trup dhe çdo pjesë që ka prerë nga trupi në këtë botë do t'i ribashkohet në botën tjetër, arrin në përfundimin se ky veprim por edhe heqja e qimeve në këtë gjendje, janë mekruh. Për më tepër, ka shumë dijetarë të fushës së jurisprudencës Islame, të cilët e kanë përfshirë këtë veprim ndërmjet veprimeve mekruh nëpër librat e tyre të fetvave. Këtu nuk duhet të harruar se harku kohor i lejuar për të mos prerë thonjtë e qimet, është deri në 40 (dyzetë) ditë, pra një njeri nuk mund të qëndrojë pa prerë qimet e thonjtë më shumë se dyzetë ditë. Nëse gjendja xhunub e mashkullit apo gjendjet e veçanta të femrës, rastisin me ditët e fundit të këtij dyzetë ditëshi dhe pritja e mbarimit të këtyre gjendjeve ka rrezik tejkallimin e normës së lejuar 40 ditë, atëherë zgjidhet rruga "e keqja më e vogël" dhe qimet prihen në gjendje xhunubi. Për gratë këshillohet që ta kontrollojnë veten e tyre para se t'u vijnë periudhat e veçanta. Nëse ka diçka për të prerë nga trupi, e mira është që mos të lihen për në ditët kur janë në gjendjet e tyre të veçanta.

A nevojitet gusul pas kontrollit të shtatzënisë tek mjekja?

Nëse bëhet kontroll nga poshtë me gishta apo sende të tjera normalisht nuk është rast që kërkon gusul. Pra nëse femra nuk ndjen kënaqësi nga kjo gjë nuk nevojitet gusul. Por, nëse femra ndjen kënaqësi atëherë nevojitet gusul. Pra gjatë vizitës tek doktoresha përkatëse, nëse me vendosjen e aparaturës femra nuk ndjen kënaqësi nuk nevojitet gusul, por, nëse ndjen atëherë nevojitet të marrë gusul.

A lejohet ngrënia dhe pirja para marrjes së gusulit?

Është mendub që një njeri në gjendjen xhunub, si fillim të marrë abdest normal dhe më pas hajë e të pijë diçka. Nëse nuk merr abdest normal, mund të lajë duart dhe të shpërlajë gojën. Nëse nuk e bën as këtë, ka kryer një veprim mekruh. Për femrat të cilat ndodhen në periudhat e tyre të veçanta nuk ka një kusht të tillë por sugjerohet larja e duarve para ushqimit apo gatimit. Në fund të fundit, larja e duarve para dhe pas ushqimit edhe në kohët normale është nga synnetet e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Fatma Karaj

Mëkati dhe pasojat e tij në jetë

I Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s. ka thënë: "Mëkati është ai që e shqetëson besimtarin në kraharor, e ai nuk dëshiron që ta dinë njerëzit." (Muslimi)

Mëkat është çdo gjë që bëhet kundër asaj që ka porositur i Madhi Zot. Mëkatet zënë vende të ndryshme shkallën e "klasifikimit" të mëkateve sipas dëmit që shkaktojnë dhe pasojave që lënë. Ata ndahen në dy lloje themelore: 1. Moskryerja e urdhrave dhe 2. Kryerja e gjërave të ndaluara e kjo e dyta zë fill që nga krijimi i njeriut. I Madhi Zot, p.sh., i urdhëroi tërë krijesat e Tij që t'i përulën krijesës së re, por këtë urdhër e kundërshtoi iblisi e me këtë ai meritoi mallkimin e Allahut dhe dëbimin e përhershëm nga mëshira e tij. Nga ana tjetër, Zoti e ndaloi Ademin të hajë frutin nga pema e ndaluar, por ai këtë ndalesë, sipas yshtjes së iblisit, nuk e zbatoi gjë që e solli atë në një situatë të vështirë. Por ai nuk mendoi si djalli, që dikush tjetër ishte fajtor për një qëndrim të tillë dhe nuk u tregua kryeneç dhe mendjemadh, por shikoi te vetja dhe u bind se dobësia ndodhej tek ai, se ai vetë është përgjegjës për qëndrimin që mbajti, sepse kishte mundësi të mos e bënte ngaqë ishte paralajmëruar për këtë e më pas ai u pendua duke iu drejtuar Allahut për

falje. Nisur nga kjo, në princip, tërë mëkatet ndahen në dy kategori. Më pas ato ndahen në mëkate të dukshme; ato që kryhen nëpërmjet organeve dhe të padukshme; ato që bëhen me zemër. Më pas ato klasifikohen në mëkate të rënda siç janë: mosbesimi te Zoti, respektivisht duke i bërë shok atij, vrasja e padrejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, dezertimi nga fusha e betejës dhe shpifja për besimtarët e ndershëm. Më pas ato ndahen në mëkate të mëdha siç janë dëshmia e gënjeshtërt, pirja e alkoolit, prostitucioni, vjedhja, etj., dhe në mëkate të vogla, numri i të cilave është i madh.

Mëkatet mund të ndahen edhe mbi një bazë tjetër. Njeriu përbëhet nga gërshetimi i mjaft cilësive nga të cilat disa kanë natyrë engjëllore, disa shtazarake, disa natyrë egërsirash dhe disa natyrë djallëzore. Të gjitha këto cilësi gërshetohen ndërmjet vetes dhe sipas rrethanave të përcaktuara, dalin në skenë ndonjëherë shumë thjesht e ndonjëherë të pleksura me të tjerat. Cilësitë shtazarake dhe mëkatet që rrjedhin prej tyre janë, p.sh., dhënia pas dëfrimeve, lakmia dhe paturpësia nga ku burojnë prostitucioni, vjedhja, ngrënia e pasurisë së jetimit, koprracia, egoizmi etj. Mëkate shtazarake janë:

agresiviteti, gjakderdhja, armiqësia, atakimi i të dobëtëve dhe i të pafuqishmëve, dhuna etj. Mëkate djallëzore janë: mendjemadhësia, gënjeshtria, ngatërresa, mashtrimi, grindja, dëshmia e rreme etj. Të gjitha këto mund e duhet t'i kontrollojë arsyeja me dritën fisnike të Shpalljes e t'i mbajë të frenuara. Në jetë është i pashmangshëm konfrontimi i këtyre cilësive, madje është shumë i shpeshtë. Njeriu vazhdimisht ndodhet në një gjendje, kur disa nga këto cilësi këmbëngulin të manifestohen, ose ndonjëherë sulen me forcë. Ndonjëra prej këtyre cilësive fshehurazi e sundon njeriun dhe ai duke iu përshtatur asaj, mbase edhe me naivitet, bëhet i ndërgjegjshëm pas njëfarë kohe, tjetra ia heq kujdesin dhe e shmang nga ajo që duhet të bënte, ndërkohë e treta e shtyn të bëjë diçka që ai e di se është e ndaluar. Cilësitë që e tërheqin njeriun me fuqi për të mëkatuar, shkencëtarët (dijetarët) i konsiderojnë "sulme" të brendshme. Sipas tyre çdo njeri, në vetvete, mbart 7 nga këto sulme e këto janë: lakmia, rrahja, xhelozia për fitim, urrejtja, keqdashja, epshi dhe mendjemadhësia. Kur ndonjëra prej tyre fiton terren te njeriu, e shtyn atë të mbajë qëndrime të përcaktuara të cilat në këtë botë janë negative për jetën e tij e që, në botën tjetër, e çojnë në njërin prej shtatë zjarreve të Skëterrës (Xhehenemit).

Mëkatet dëmtojnë edhe jetën e kësaj bote të njeriut

Zakonisht njerëzit mendojnë se duke iu përkulur Allahut, arrihet vetëm dobia dhe lumturia e asaj bote, ndërsa me mosbindjen ndaj Zotit, do të ketë vetëm dëmtime dhe fatkeqësi në botën tjetër, duke dhunuar kështu porositë për këtë botë e duke i shtyrë në zonat që ndodhen "atje pas..."

Për këtë shkak disa njerëz u përshtaten gjërave që i Madhi Zot i ka ndaluar e me të cilat ata synojnë të arrijnë dobitë e kësaj bote, duke harruar plotësisht Botën tjetër, e duke shpresuar ose te mëshira e të Madhit Zot ose duke mos besuar tek ekzistenca e botës tjetër. Por me këto përcaktime të vetat, ata humbasin jo vetëm Botën tjetër, por edhe në këtë botë bëhen fatkëqij, duke humbur kështu realisht edhe njërin edhe tjetrën. Ata nuk janë të ndërgjegjshëm që adhurimi ndaj Zotit i sjell njeriut mirësi dhe fat edhe në këtë botë edhe në tjetrën, e mosdëgjimi i porosive të Zotit i sjell njeriut fatkeqësi jo vetëm "asaj atje larg" (Botës tjetër), por edhe kësaj në të cilën po jetojnë.

"Allahu sjell si shembull qytetin (Mekës) që ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i vinin ushqime të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij i mohuan begatitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë dhe frikën si ndëshkim për atë që bënë". (Nahl, 112)

Është e qartë plotësisht se, çdo gjë që Allahu e ka ndaluar si: terrorizimi i njerëzve, padrejtësia, dhuna, marrëdhënia seksuale jashtëmartesore e homoseksualizmi, vjedhja, konsumimi i pijeve dehëse, egocentrizmi, dëshmia e rreme, gënjeshtria, shpifja, etj., lënë pas vetes pasojë jashtëzakonisht të këqija dhe

e bëjnë jetën e njeriut gjithnjë e më të keqe e më të rëndë, plot ankth. Njeriu i sotëm, që jeton në kohën e përgjumjes drastike (harresës) ndaj ligjeve fetare dhe sanksioneve, e që përballet direkt me to, gjithnjë e më tepër është i pakënaqur me jetën e vet, gjithnjë e më tepër ndien "mallëngjim" nostalgji për "atë që ka kaluar".

Porositë, ligjet islame, e ndihmojnë njeriun për ta çuar te përputhja e jetës së sotme me natyrën e kaluar dhe me ligjet e saj. Për këtë arsye disa autorë si, p.sh., Sejjid Kutubi, ligjin islam e quan "Kozmik". "Sheriati, - thotë ai, - që e ka urdhëruar i Madhi Zot për rregullimin e jetës së njeriut, është, - sipas tij, - sheriati i përbotshëm, është i integruar në ligjin e përgjithshëm të njerëzisë e është i përputhur me të. Prandaj, mbajtja, respektimi e zbatimi i këtij sheriati kërkon, përkon me arritjen e domosdoshme të përputhjes së jetës së njeriut me lëvizjen e gjithësisë ku ai jeton. Për më tepër, ata kërkojnë arritjen e domosdoshme të përputhjes së ligjeve që sundojnë natyrën e padukshme të njeriut dhe të atyre që rregullojnë formën e jashtme të jetës së tij dhe të harmonizimit të domosdoshëm të personalitetit të jashtëm dhe të brendshëm."

Mëkatet kërkojnë largimin, tërheqjen nga kjo dhe e çojnë njeriun në konfrontim me rregullin e natyrshëm të gjërave, provokojnë ndërrimin e mjedisit të jetës dhe shkaktajnë pëshqjellimin e baraspeshës dhe çrregullimin. Kur'ani në shumë vende flet për këtë fakt: "...Ka vendosur masën, që të mos e kaloni kufirin (masën)". (Rahman, 7-8)

"Shkatërrimi në tokë e në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që Allahu do t'i bëjë 'të shijojnë' pjesë nga ajo që kanë bërë, me qëllim që të rregullohen." (Rum, 41). Kjo do të thotë se pëshqjellim të tillë nuk kishte para se njeriu të shfaqej mbi tokë, deri atëherë proceset zhvilloheshin sipas dinamikës së natyrshme dhe ligjeve të brendshme pa ndikimin e krijësave të gjalla të cilat nuk mund të sillleshin ndryshe, por sipas asaj që i fryu, krijoi Zoti i tyre sipas instinkteve me të cilët ishin pajisur. Vetëm njeriu, duke falënderuar arsyen dhe lirinë e dëshirës që i janë dhënë si supozime të domosdoshme për realizimin e qëllimeve për të cilët është krijuar, mund të vepronte kundër pëshqjellimeve të ndryshme të gjërave dhe me këtë, jashtë ndikimeve mbi to, t'i shkatërronte dhe në to të provokonte ngatërresat.

Mëkatet duhet të shmangen, të luftohen

Allahu ka vënë sanksionet për shkelësit e porosive dhe ka urdhëruar zbatimin e këtyre sanksioneve që puna të mos vinte deri këtu.

"Të mos ju pengojë asnjë lloj mëshire për të kryer detyrën e fesë së Allahut, për të zbatuar sanksionet e parashikuara, nëse besoni Allahun dhe Botën tjetër dhe dënimin e tyre le ta shikojë një grup tjetër besimtarësh." (Nur, 2).

"Sheriati parashikon sanksione që zbatohen mbi tokë, - thuhet në një hadith, - atyre në tokë u sjell më

shumë të mira sesa shiu që do të binte 40 mëngjese." Sanksionet vendosen që të frenohet kryerja masive e mëkateve, sepse kur ato kryhen si individ, dëmi i tyre kufizohet vetëm te një person. Kur njerëzit nuk i zbatojnë këto sanksione, atëherë mëkatet shumohen dhe fillojnë të bëhen sheshit dhe në një masë të madhe pa u dënuar dhe përhapen si infeksion. Për më tepër, djalli ua ëmbëlson njerëzve këtë gjendje dhe ata fillojnë të krenohen me atë që bëjnë, pa qenë të vetëdijshëm se këto punë do të rezultojnë me pasoja të këqija për vetë ata. Me fjalë të tjera, mëkatet verbojnë syrin shpirtëror e për rrjedhojë njerëzit nuk shohin dritën e vërtetë. Atëherë njerëzit shkaktojnë parregullsi e fillojnë të bëjnë vepra që janë në kundërshtim me harmoninë e natyrshme e për rrjedhim provokojnë rrëmujë, pështjellim në natyrë, krime, frikë të ndërsjellë nga njëri-tjetri, ndërprerje të lidhjeve farefisnore, lidhjeve familjare dhe ato të fqinjësisë, etj. Në Kur'an thuhet: "Ruajuni ngatërresave, nuk të cilat nuk godasin vetëm ata që bëjnë keq; dhe ta dini se Allahu dënon ashpër". (Enfal, 25).

I Dërguari a.s. ka paralajmëruar lidhjen shkak-pasojë ndërmjet mëkatit dhe pasojës që ai shkakton në jetën reale: "Kur të shfaqet te një popull korrupsioni duke e ushtruar sheshit, ky popull do të përballet me epidemitë dhe sëmundjet që nuk ekzistonin te paraardhësit e tyre; kur një popull fillon e peshon mangët, ai përballet me thatësinë, me skamjen, me varfërinë, me tiraninë e kur e ndërpresin zekatin nga pasuria e tyre, pakësohet ujët nga qielli e po të mos kishte kafshë, asnjëherë nuk do të binte shi." Dhe, më poshtë shton: "Njeriut me të vërtetë mund t'i pakësohet furnizimi për shkak të mëkateve që ka bërë". Komentuesi i famshëm Ibni Kethiri thotë: "Njerëzit kur fillojnë të mëkatojnë hapur, do të kenë si pasojë humbjen e bereqetit, edhe nga qielli edhe nga toka. Prandaj kur të ulet sërish Isai a.s., biri i Merjemes, para fundit të kohës së tokës, dhe të fillojë gjykimin me shariatën e pastër në këtë kohë dhe kur Zoti do të zhdukë Dexhalin dhe ithtarët e tij dhe Jexhuxh Maxhuxhin, atëherë do t'i thuhet tokës: 'Nxire në dritë bereqetin tënd!'".

Prandaj njeriu nuk duhet ta kërkojë diku tjetër, të dyshojë të dikush tjetër me atë që ai përballet, sepse ai në këtë rast do të bëjë një mëkat tjetër; mëkat duke dyshuar te një tjetër i cili është i ndaluar me shprehjen kuranore: "O ju që besoni, mënjanoni shumë dyshime." (Huxhurat, 12). Krahas kësaj po sjellim porosinë e kundërt kuranore: "Prandaj mos u lavdëroni me pafajësinë tuaj!" (Nexhm, 32). "Njeriun as druri nuk e gërvishet, as këmba nuk i pengohet, as damari nuk i dridhet, nga shqetësimi e që mos të jetë shkakuar nga një mëkat. Por mëkatet që i janë falur janë më të shumtë", - thotë i Dërguari.

Kur të Dërguarin e përfshinte ndonjë nevojë, ai, siç dihet, e shtonte adhurimin, kërkonte më tepër falje, dhe i lutej të Madhit Allah, që t'i falte mëkatet, nisur kjo nga udhëzimi kuranor. "Kërkoni ndihmën e Allahut me durim

e namaz. Kjo me të vërtetë është e vështirë, përveç të devotshmëve". (Bekare, 45)

Duke i marrë dituritë direkt nga i Dërguari a.s., myslimanët e parë e kanë pasur vetëdijen jashtëzakonisht të zhvilluar për humbjen e ndikimit të mëkatit mbi të vërtetën e jetës te njerëzit. Ata ishin të ndërgjegjshëm për pasojat e këqija që kanë mbi tërë gjendjen në tokë.

Prandaj myslimani duhet ta kundërshtojë të keqen, mëkatin, me njërën nga tri mënyrat: ta ndalojë me dorë në qoftë se mundet, në qoftë se nuk është në gjendje ta ndalojë me dorë, le ta ndalojë me gjuhë duke e këshilluar mëkatarin që të mos mëkatojë, pra verbalisht, në qoftë se edhe këtë nuk mund ta bëjë, atëherë ta dënojë, ta përbuzë me zemër, por kjo është besimi më i dobët. Por me këtë të fundit, - thotë i Dërguari, - nuk ka besim të plotë as sa një kokërr hardalli." Në rast se njeriu nuk e dënon mëkatin as me zemër, në qoftë se solidarizohet me kryerjen e mëkatit, kjo do të thotë se zemra e tij është e vdekur dhe boshe, e zbrazur nga besimi i vërtetë.

Ndikimi i mëkatit te njeriu

Ndikimin më të madh mëkatet e kryejnë mbi shpirtin e njeriut. Ato veprojnë mbi të siç veprojnë helmet mbi trupin. Por është fitimtar i suksesshëm vetëm ai njeri, që arrin ta ruajë të pastër zemrën e tij. Jeta e tij edhe në këtë botë do të mbushet me kënaqësi dhe qetësi, por edhe në botën tjetër do të jetë midis të lumturve: "Dhe mos më turpëro atë ditë kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër, tek Allahu ai do të shpëtojë". (Shura, 87-89)

I Dërguari thotë: "Kur njeriu bën një mëkat, mbi zemër i shfaqet një njollë e zezë e në qoftë se pendohet dhe e le mëkatin e i lutet Allahut për falje, ajo njollë zhduket, por në qoftë se rritet numri i mëkateve, rritet edhe njolla e zezë. Kështu vazhdon derisa i mbulohet zemra. Ky është ai mëkatar që e përmend Allahu në Kur'anin e Madhërishtëm: "Nuk është ashtu, por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat." (Mutaffinë, 14). Vazhdimi në mëkatime e zvogëlon në zemrën e njeriut respektin ndaj të Madhit Zot dhe i dobëson dëshirën për adhurim e mirëbërje. Zemra përshtatet, mësohet me mëkatin dhe ai gradualisht i bëhet i ëmbël e i dashur dhe njeriut i duket i bukur e si përfundim njeriu verbohet shpirtërisht. "Por nuk u janë verbuar sytë, por zemrat në kraharor." (Haxh, 46). Atëherë njeriu nuk e sheh të vërtetën si të vërtetë, e njeriu pushon së ndjeri për mëkatet që bën dhe e kalon kufirin që i ka vënë Zoti i tij. "Këto janë kufijtë e Allahut, prandaj mos i kaloni, mos i shkelni ato!" (Bekare, 149) Ajo që është brenda kufijve që ka vendosur Allahu është plot mëshirë dhe mirësi për njeriun edhe për botën ku jeton, e ajo që i kalon kufijtë mbart në vetvete mallkim. Sipas kësaj, duke kaluar këto kufij, njeriu hyn në zonën e mallkimit e në këtë errësirë humbet orientimin.

Mëkati e robëron njeriun

Islami e trajton njeriun si zëvendësin e Allahut mbi tokë, që do të thotë se ai duhet të drejtojë, të udhëheqë çdo gjë që ndodhet mbi të. Pra asgjë nuk mund ta sundojë e ta nënshtrijë njeriun e ta bëjë vartësin e vet. Kjo nuk do të ndodhë përderisa ai të jetë pranë Zotit të vet, për aq kohë sa ai të dëgjojë e të respektojë fjalën e Tij e për aq kohë sa t'i dorëzohet Atij. Ai duhet të jetë i lirë që ta angazhojë arsyen e vet për respektimin e Librit të Zotit, në hulumtimin e botës ku jeton ai dhe pranimin e rezultateve që arrin dituria e tij. I Madhi Zot u ka premtuar atyre që i përuken Atij se do të kenë jetë të mirë, plot kënaqësi e fat. "Kush punon mirë, mashkull apo femër qoftë, e është besimtar, Ne me të vërtetë do t'i japim atij të kalojë jetë të mirë." (Nahl, 97), ndërsa për të tjerët ka thënë se do të kenë "jetë të vështirë" (Taha, 123). Që njeriu të mund të kryejë detyrën ndaj Zotit, arsyeja e tij, nuk duhet të shqetësohet, të ngatërrohet në lidhjen midis tij dhe Zotit të vet. Kjo lidhje është e shenjtë dhe nuk duhet të priset për asnjë arsye. Në qoftë se diçka tjetër ia robëron arsyen si alkooli apo droga e dehin, ndjenja, hardallosja, ose zemërimi e verbojnë, lakmia e huton, dembelizmi e mpin, e vdes, ai nuk mund ta kryejë rolin e tij si halife, atë të zëvendësit të Zotit dhe poshtërohet si krijesë. Duke vazhduar me çdo lloj mëkati, njeriut i pakësohet aftësia për të marrë dituri, që është baza për kryerjen e detyrave fetare dhe të kryejë rolin e zëvendësit të Zotit mbi tokë. Në traditën islame ka shumë argumente që flasin për këtë gjë. Imam Shafiu, i njohur për memorien e tij të fuqishme, një herë iu ankua mësuesit të vet se në disa ditë i dobësohet memoria. Atëherë mësuesi e udhëzoi te shërimi efikas: "Mos mëkato!" i tha ai, "-dhe çliroje zemrën nga çdo gjë që të të kthejë te Zoti yt!". Imam Shafiu në lidhje me këtë ka shprehur këto vargje:

"U ankua Vekiu për memorie të dobët, e ai i tha: lëri mëkatet dhe shtoi: dituria është dritë dhe drita e Allahut nuk vjen duke mëkatuar".

Për aq kohë sa njeriu i përuket Allahut, ai është rob i Zotit dhe asgjë tjetër nuk mund ta robërojë njeriun që i përuket Allahut, është njeriu më i lirë, ai është në paqe dhe në harmoni me natyrën, është i kënaqur dhe asgjë tjetër nuk mund ta çorodisë zemrën e tij. Ndërkohë, kur i shmanget përules ndaj Allahut, atëherë diçka tjetër e robëron atë dhe e bën vartësin e tij, që nuk është si më parë dhe atij nuk i vjen më mirësia. Kështu në vend që të jetë zotërues i çdo gjëje mbi tokë, rol që ia ka caktuar Allahu, ai bëhet shërbëtor i dikujt.

Mëkatet shkurtojnë jetën

I Dërguari i Zotit a.s. thotë: "Ai që dëshiron t'i jepet rrësk i bollshëm e t'i zgjatet jeta, të mbajë lidhjet farefisnore!" Ky hadith kuptohet në mënyra të ndryshme nga dijetarët. Disa thonë se me këtë kuptohet që mëkatarit i merret bereqeti nga jeta e tij për shkak të mëkateve, aq sa nga jeta e tij sado e gjatë qoftë, ai nuk do të ketë asnjë

dobi. Të tjerët thonë se mëkatarit realisht i pakësohet jeta e gjallë dhe nafaka (13), ndërsa të tretët mendojnë që mëkatet e largojnë jetën e vërtetë, jetën e zemrës etj.

Allahu i madhëruar ata që nuk besojnë, i konsideron si të vdekur, jo të gjallë.

"Me të vërtetë, ti (Muhamed,) nuk mund të bësh që 'i vdekuri' apo 'shurdhi' të dëgjojnë thirrjen, kur ata të kthejnë shpinën duke u larguar, as të verbrit nuk mund t'i kthesh nga mashtrimi, mund të thërrasësh vetëm ata që besojnë ajetet tona, fenë tonë, ata janë myslimanë të vërtetë." (Rrum 52, 53; Neml, 80). "Ky është Kur'ani i qartë, që të kujtojë që është gjallë dhe të përmbushet fjala e tij ndaj femohuesve." (Jasin, 69-70).

Shumica e komentuesve të Kur'anit mendojnë se sintagma "ai që është gjallë" ka dy kuptime; Me njerin nënkuptohen njerëzit e gjallë, ata që nuk e kanë lënë akoma këtë botë, ndërsa me të dytin, ata që e kanë gjallë zemrën e ajo është në gjendje të pranojë porosinë e Zotit, e ajo absorbon te zemra qetësi dhe kënaqësi. Sipas kësaj jeta është diçka e ndryshme nga jeta e gjallë ashtu siç janë dy gjëra të ndryshme "jetoj jetën" dhe "të jesh gjallë".

Sipas kësaj, kur njeriu e braktis Allahun dhe jepet pas dëfrimeve, ai në të vërtetë humbet kohën që i është dhënë në këtë botë, respektivisht e humbet këtë kohë dhe me këtë shkurton jetën e vet. Ai do të ndërgjegjësohet për këtë më vonë, atëherë kur siç thotë Kur'ani, "...njeriu do të kujtohet e për çfarë do të kujtohet? Ai do të thotë: 'Ah, sikur të kisha përgatitur diçka të mirë për jetën time?!'" (Fexhr, 23-24).

Njeriu nga jeta e tij e gjallë ka jetë vetëm aq sa ka përjetuar në përuken ndaj Allahut aq sa ka respektuar Allahun e Madhëruar, aq sa ka qenë i pranishëm me shpirt në kryerjen e namazit. Kështu, sipas kësaj mase, jeta e dikujt vazhdon dy, e dikujt tjetër dhjetë, e dikujt tjetër njëzet vjet... Po kështu mund të thuhet edhe për pasurinë e njeriut, për diturinë e tij dhe për punët që ka bërë. Njeriu mund të ketë shumë pasuri, një grumbull të madh ari dhe argjendi, ndërsa vlera e gjithë kësaj, në thelb, nuk është më tepër se disa groshë, sepse edhe kjo, përderisa nuk e ka ndjekur qëllimi që me anë të saj të arrihet kënaqësia e Allahut, kjo është e vdekur dhe nga pikëpamja islame e pa vlefshme në thelb. Çdo njeriu jeta i dhuron nijetin e singertë, qëllim që me të të jetë sa me afër Allahut. "Kjo botë është e mallkuar", -thotë i Dërguari a.s., - "dhe çdo gjë tek ajo është e mallkuar, përveç përmendjes (dhikrit) së Allahut dhe atë që është në miqësi me të, pra me mësuesin, dijetarin dhe shkencëtarin".

Përktheu nga boshnjakishtja:

H. Ismail Dizdari

PUNA NË ASPEKTIN

Islam

Allahu (xh.xh.) e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, i ka dhënë mendjen dhe logjikën, aftësinë për të mësuar; më pas e ka ngarkuar atë me përgjegjësi, të cilat mund ti ndajmë si përgjegjësi ndaj Zotit si krijuesin e tij, përgjegjësi ndaj vetes, familjes e më pas ndaj të gjithë shoqërisë. Profeti (a.s.) në njërin nga hadithet e tij, ja kujton me këto fjalë përgjegjësinë që besimtari ka në dynja:

“Gjithsecili prej jush është kujdestar dhe gjithsecili prej jush është përgjegjës për gjithë ç’ka nën mbikëqyrje

dhe nën kujdesje: Kështu, imami (sunduesi, prijësi) është kujdestar për gjithë ç’ka ai nën sundim dhe është përgjegjës (e përgjigjet) për ata që ai ka në vartësi; edhe burri është kujdestar i familjes së vet dhe përgjegjës për ta; edhe gruaja është kujdestare e shtëpisë së burrit të saj dhe përgjegjëse për të; edhe shërbyesi është kujdestar i pasurisë së padronit të vet dhe përgjegjës për të.”

Sipas hadithit secili prej nesh ka përgjegjësi dhe detyra
1. Sahihu i Buhariut, hadithi nr. 5188.

të caktuara. Pas adhurimit ndaj Zotit, detyra më sublimë që ka njeriu është të formojë mirëqenie për veten dhe për ata që ka nën kujdesin e tij. Puna ka qënë motoja e çdo profeti dhe duhet të jetë motoja e çdo besimtar.

Puna jo vetëm që është mjeti i vetëm për të siguruar dhe ndërtuar një jetesë dinjitoze për veten dhe familjen, për të ruajtur fenë, nderin dhe dinjitetin e tyre, por në të njëjtën kohë është edhe detyrë fetare, dhe njëra nga mënyrat më të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Profetët, njerëzit më të veçantë, të cilët kanë qenë të ngarkuar më detyra shumë të rëndësishme nga Allahu, siç është shpjegimi i mesazhit hyjnor dhe përfaqësimi në mënyrën më dinjitoze i këtij mesazhi, siç është rimëkëmbja e shoqërisë nga ana morale dhe shpirtërore, nuk e kanë neglizhuar edhe aspektin e punës që ka të bëjë me sigurimin e jetesës në dynja. Megjithëse kanë qenë shumë të impenjur në edukimin e njerëzve, rimëkëmbjen e shoqërisë nga ana e besimit dhe moralit, që është punë e vështirë e cila kërkon shumë përkushtim, kohë dhe angazhim, përsëri kanë gjetur kohë, kanë mësuar profesion dhe e kanë siguruar jetesën e tyre në saj të punës. Nuk kanë pritur nga të tjerët, nuk kanë pranuar nga të tjerët, por kanë punuar dhe janë bërë shembull për besimtarët që dëshirojnë të ndjekin rrugën e tyre. Të gjithë Profetët kanë pasur profesione të caktuara, Ademi (a.s.) ka qenë bujk, Idrisi (a.s.) ka qenë rrobaqepës, Nuhu (a.s.) ka qenë marangoz etj... Edhe Profeti Muhamed (a.s.) ka punuar që në rininë e tij, fillimisht si bari i deleve te Mekasve² e më pas si tregtar në karvanet e Hatixhes (r.anh.). Profeti Muhamed (a.s.) e lavdëron dhe e tregon si shembull të mirë Davudin (a.s.), i cili ka qenë hekurpunues:

“Asnjëherë ndonjëri nuk ka ngrënë ushqim më të mirë, sesa atë të cilën e ka fituar me duart e veta. Edhe profeti i Allahut Davudi (a.s.) ka ngrënë vetëm nga ajo që ka fituar me duart e veta.”

Pse është i rëndësishëm si shembull Daudi (a.s.)? Është i rëndësishëm sepse Daudi (a.s.) ka qënë mbret, sundimtar i cili kishte mundësi të mos punonte fare dhe të bënte një jetë të rehatshme, mirëpo ai kishte mësuar profesion dhe punonte, dhe si i tillë simbolizon besimtarin ideal i cili gjithmonë duhet të jetë produktiv. Sado i pasur të jete njeriu duhet të mësojë profesion dhe të mësohet me kulturën e punës. Askush nuk e ka të sigurtë të nesërmen e tij, për një kohë të shkurtër mund ti humbë të gjitha, shumë miliarderë kanë falimentuar në një kohë shumë të shkurtër dhe janë zhytur në borxhe të mëdha, apo njerëz të tjerë të pasur, të cilët kanë rënë në gjumë si të tillë dhe janë zgjuar të varfër, kanë humbur gjithçka prej termetit apo fatkeqësive të tjera natyrore.

Islami e nxit çdo musliman të jetë anëtarë produktiv i shoqërisë, e nxit të prodhojë të fitojë dhe të mos kërkojë nga njerëzit e tjerë. Myslimani duhet ta ruaj dinjitetin dhe krenarinë e tij, të mos e dëmtojë atë duke lypur, gjë e cila ndikon që njerëzit ta shohin me nënçmim dhe përbufje.

Sipas rrëfimit të Enes b. Malikut (r.a.), një sahabi shkoi te Profeti (a.s.) dhe i kërkoi lëmoshë.

Profeti (a.s.) e pyeti: “A s’ të ndodhet gjë në shtëpi?”

Ai iu përgjigj: “Po o i Dërguar i Allahut, kam një shtrojë që e përdor për ta shtruar dhe për mbulojë dhe një enë për të pirë ujë.”

Profeti (a.s.) e dërgoi atë në shtëpi për t’ia sjellë mbulesën dhe enën. Pastaj i shiti vetë ato për dy derhem dhe i tha kështu sahabiut: “Me një derhem blij ushqim për familjen dhe lëri në shtëpi, kurse me derhemin tjetër blij një sëpatë dhe eja prapë tek unë!”

Sahabiu u kthye tek Profeti (a.s.) me sëpatë në dorë, ai e porositi më këto fjalë sahabiut: “Shko tani, bëj dru dhe shiti. Për pesëmbëdhjetë ditë të mos të të shoh më këtu!”

Sahabiu u largua, bëri dru, i shiti dhe fitoi dhjetë derhemë. Me një pjesë të tyre bleu rroba, kurse me pjesën tjetër, ushqime. Atëherë, Profeti (a.s.) i tha: “Kjo është më mirë për ty sesa të vijë lypja si pikë e zezë në fytyrën tënde Ditën e Kiametit. Lypja është e lejueshme vetëm për këta tre persona: për të varfërin e uritur dhe aq të drobitur sa të mos ngrihet dot në këmbë, për atë që ka hyrë në një borxh që s’e përballon dot dhe për atë që s’e paguan dot borxhin e vrasjes pa dashje apo plagosjes!”³

Islami nuk e ka ndaluar që nevojtarët të kërkojnë nga të tjerët, megjithëse moralisht nuk e ka pëlqyer atë.

Puna jo vetëm që i siguron besimtarit një jetesë dinjitoze, por në të njëjtën kohë është adhurim, adhurim i cili të përfiton kënaqësinë e Allahut. Profeti (a.s.) e ka krahasuar punën me Xhihadin. Të dyja shërbejnë për të mbrojtur ata gjëra që çdokush i ka të shejnta; si lirinë e besimit dhe mendimit, nderin dhe jetën.

Një ditë, para Profetit (a.s.), kaloi një djalë i ri dhe i fuqishëm fizikisht. Sahabët që gjendeshin aty me Profetin thanë:

– O i dërguar i Allahut! Sa mirë do të ishte, në qoftë se ky njeri do të luftonte në rrugën e Allahut!

Profeti (a.s.), iu përgjigj atyre:

– Në qoftë se ky njeri ka dalë nga shtëpia e tij me qëllim që të punojë për të fituar bukën e fëmijëve të tij, ai është në rrugën e Allahut. Në qoftë se ka dalë që të kryejë nevojat e prindërve të tij, ai është në rrugën e Allahut. Në qoftë se ka dalë të fitojë bukën e tij, ai është në rrugën e Allahut. Në qoftë se ka dalë për t’u dukur rrugëve, ai është në rrugën e shejtanit. (Et-Tergib vet-Terhib, vol. 2, fq. 254.)

Në atë kohë besimtarët po kalonin një periudhë shumë të vështirë, po luftonin për egzistencë, prandaj sahabët dëshironin ta shikonin këtë të ri, të fuqishëm fizikisht, si ushtar, mirëpo Profeti (a.s.) ju dha një mësim të vjeshëm atyre, dhe ne emër të tyre të gjithë besimtarëve: “Puna është po aq e rëndësishme dhe e vlefshme sa edhe vetë xhjadi.”

Erjol Haxhiu

2. Sahihu i Buhariut; Hadithi nr. 2262.

3. Ebu Davud, Zekat, 1641.



Rënkimi i MJEDISIT

Zoti e krijoi njeriun si qenien më të lartë në univers, që me vullnetin e tij të lirë të ndërtojë jetën në harmoni të plotë me të gjitha ekzistencat sipas një etike të caktuar. Respekti ndaj çdo krijese dhe si rrjedhojë, respekti i natyrës dhe mjedisit dhe në të cilin jetojmë, është një urdhër hyjnor dhe një vlerë universale të cilën e gjejmë në fetë abrahamike e gjithashtu te të gjitha fetë e tjera në botë. Nisur nga kjo, shumë mendimtarë në ditët e sotme shprehen se fetë mund të japin një kontribut të rëndësishëm në vetëdijesimin tonë për ruajtjen e mjedisit që na rrethon. Kështu burimet e literaturës islame përbëjnë një burim të rëndësishëm frymëzimi dhe botëkuptimi në lidhje me këtë çështje. Në këndvështrimin e Kuranit, të gjitha qeniet e gjalla dhe jo të gjalla janë krijesa të Zotit që reflektojnë Ekzistencën dhe Madhështinë e Tij i cili e ka krijuar çdo qenie në formën më të bukur: "Ai që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta."¹ "Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë. Edhe yjet dhe bimët i bëjnë përulje Atij. Ai e ngriti qiellin dhe Ai vuri drejtësinë. Që të mos kaloni kufirin në drejtësi. dhe matni drejt e mos mungoni në tërësi! Ai edhe tokën e bëri të shtrirë për krijesat."²

1. Kuran 32:7

2. Kuran 55:5-10

Në Kuranin Famëlartë, njeriu cilësohet si məkëmbësi i Zotit në tokë. Duke qenë i vetëdijshëm për ekuilibrin dhe pastërtinë që ekziston në natyrë, ai duhet të jetë i vetëdijshëm për mundësitë që i janë dhënë, dhe në këtë formë duhet të ndërtojë jetën e tij. Kështu mirësitë e Zotit në jetën e tij janë një dhuratë që njeriu nuk duhet ti shpërdorjë duke prishur ekuilibrin në krijimin e Tij në mënyrë që të shpërblehet pafundësisht në botën e përtejme. Në të kundërt, ai do të mbajë përgjegjësi për këtë mëkat për të dhënë llogari në botën tjetër. Kështu që, ai është i ngarkuar me përgjegjësinë të veprës sipas një etike të caktuar më mirësitë që Zoti i ka dhuruar në këtë botë.

Natyra është një thesar përplot me mirësi që Zoti ia ka krijuar për njeriun. Lëndët prej të cilave ai përfiton, gjenden në forma dhe gjendje të ndryshme në natyrë. Disa prej tyre janë të gatshme, si përshebull frutat që marrim nga pema, ndërsa disa të tjera gjenden të papërpunuar dhe mund të përftohen pas një përpunimi të caktuar. Pra, njeriu duke i kaluar shumë gjëra në një përpunim të caktuar ka aftësinë të prodhojë për të plotësuar nevojat e tij. Por, të prodhosh, në një kuptim do të thotë ti konsumosh lëndët që gjenden në natyrë. Kështu njeriu duhet të jetë i kujdesshëm në konsumimin apo prodhimin



e produkteve të caktuara. Përveç kësaj, si rrjedhojë e procedurave që ndiqen gjatë prodhimit dhe konsumimit të diçkaje çlirohen materiale të dëmshme. Nëse duam që njerëzimi në tokë të vazhdojë ekzistencën dhe të jetojë në qetësi, atëherë ruajtja e ekosistemit është një detyrë themelore. Sepse ashtu sikurse thuhet në një fjalë të urtë, "Bota nuk është një trashëgimi që na e kanë lënë të parët tanë, por një borxh që ne ia kemi marrë fëmijëve tanë. Nëse e prishim ekuilibrin dhe harmoninë që qëndron në univers edhe veten tonë do ta dëmtojmë, edhe fëmijëve do ti lëmë një botë të pajetueshme."

Jeta jonë është një përpjekje për të reflektuar moralin e Krijuesit tonë. Sipas njohurive të sotshme, në botë gjenden përafërsisht tre milionë lloje gjallesash të cilat e ndotin ambientin në mënyrë të vazhdueshme. Ashtu sikurse e dimë edhe nga jeta jonë, nëse përfytyrojmë që një ditë të mos mblidhen mbeturinat e qytetit në të cilin jetojmë, do ta kthejmë atë në një gjendje të pajetueshme. Por vëzhgojmë që Krijuesi Fuqplotë me reflektimin e emrit Kuddus³ mundëson që natyra të pastrohet dhe kthehet në gjendjen e mëparshme. Këto çështje ashtu sikurse ndodhin në mikrokozmos në nivelin e qelizave ndodhin

3. I Shenjtë, i Pastërti. Allahu s'ka të bëjë me asnjë lloj të mete e mungese, është i pakufizueshëm e i papërshkrueshëm, është i përsosur në çdo veçori të Tij dhe krejt i pastër.

edhe në makrokozmos si në tokë, qiell dhe dete. Për shembull, eritrocitet (qelizat e kuqe të gjakut) në gjakun tonë, përmes molekulës së hemoglobinës në strukturën e tyre, mbledhin dioksidin e karbonit, i cili formohet si gaz i mbeturinave si rezultat i djegies në qeliza, dhe e transmetojnë atë në mushkëritë tona, dhe më pas ky gaz lëshohet në atmosferë. Në anën tjetër, leukocitet (qelizat e bardha të gjakut), të cilat janë elementë të sistemit imunitar në gjakun tonë, shkatërrojnë qelizat e huaja (mikrobet) që kanë hyrë në trup dhe qelizat që janë dëmtuar në inde, nuk mund të kryejnë funksionet e tyre dhe mund të jenë të dëmshme në të ardhmen. Siç shihet, si manifestim i emrit Kuddus të Zotit tonë të Plotfuqshëm, universi vazhdon të funksionojë në mënyrë të përkryer në të gjitha dimensionet e tij.

Dimensioni fizik dhe ai metafizik janë dy anë plotësuese dhe qenësore në ekzistencën e njeriut. Jeta e tij është një sfidë për të jetuar në pajtueshmëri me mësimet hyjnore në mënyrë që të arrijë purifikimin e zemrës së tij. Si mëkëmbës i Zotit në tokë, njeriu ka përgjegjësinë të jetojë në harmoni të plotë me natyrën dhe të veprojë mbi të sipas një etike të caktuar. Allahu na drejtohet kështu në Kuranin Famëlartë: "Ne çdo send kemi krijuar me masë

të caktuar.⁴ Pra, të gjitha qeniet i binden në mënyrë të pavetëdijshme Vullnetit hyjnor. Kështu edhe njeriu duhet të orientojë vullnetin e tij drejt mirësisë për të jetuar në harmoni me të gjitha ekzistencat në univers.

Kur flitet për mjedisin, para së gjithash nënkuptohet vendi në të cilin jetojmë, uji që pimë, ajri që thithim dhe hapësirat në të cilat shëtisim. Ne dëshirojmë që ato të jenë të pastra. Përtej mbrojtjes së mjedisit në një kuptim të ngushtë, atë duhet ta mendojmë edhe në kontekstin global. Në mënyrë paradoksale, njeriu i cili e ndot mjedisin, gjendet përballë detyrës për ta ruajtur atë të pastër. Në këtë kontekst, në Traditën Profetike na përcillet një sistem edukimi për tu vetëdijësuar në lidhje me mbrojtjen mjedisin sipas disa normave të caktuara. Profeti ynë i dashur, na mëson se ruajtja e mjedisit lidhet ngushtë me shëndetin e njeriut nëpërmjet parimeve të mjekësisë parandaluese. Ai thekson parimin e pastërtisë si parandalues kundër shumë sëmundjeve ngjitëse dhe mikrobeve duke thënë, "Pastërtia është gjysma e besimit". Për hapësirat e gjelbra ai na mëson kështu duke thënë: "Nëse ndonjëri prej jush ka një filiz në dorë në momentin kur do bëhet kijameti, atëherë le ta mbjellë atë menjëherë! Allahu do ta shpërblejë atë në botën tjetër për këtë mirësi." Një thënie e tillë përbën një frymëzim të madh për mbjelljen e pemëve duke qenë se kërkohet prej besimtarit ta mbjellë atë edhe pse gjendet në momentet e fundit të jetës së tij. Gjithashtu Profeti a.s, banorëve të Medinës i këshilloi të krijonin në afërsi të qytetit një hapësirë të gjelbër me një gjerësi prej 20 km. Ai gjithashtu e pati shpallur Mekën dhe Medinën si zona të mbrojtura ku nuk lejohet prerja e pemëve, gjuetia e kafshëve dhe prerja e të mbjellave.

Përgjatë shekujve besimtarët e feve të ndryshme i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë ruajtjes së mjedisit në vendbanimet e tyre. Që prej fillimit të revolucionit industrial në gjysmën e dytë të shek.19, dëmet ndaj mjedisit kanë ardhur duke u shtuar. Të kapluar nga pangopësia dhe shpërdorimi, shoqëritë e kanë parë natyrën si një burim shfrytëzimi sikur nuk do të shterojë asnjëherë duke harruar që natyra ka kufijtë e saj për ta ruajtur pastërtinë dhe balancën që gjendet në ekzistencën e saj. Njerëzit fetarë gjithashtu e kanë neglizhuar ti vënë në pah dëmet në këtë aspekt. Duke marrë parasysh rolin e kufizuar të fesë në shoqëri moderne, ata mund të kenë qëndruar të distancuar për të mos u damkosur si pengues të industrializimit dhe zhvillimit shoqëror. Megjithatë, ishin po këta njerëz në vitet 1950 filluan të flisnin për dëmet që po pësonte mjedisi. Në vitet 1970 fillojë të ngrihej zëri fillimisht në perëndim e më pas filloi të përhapej në shoqëritë myslimane. Që prej kësaj kohe, edhe teologët, të frymëzuar nga tekstet fetare u solidarizuan duke përçuar një ndjeshmëri të shoqëria në lidhje me kujdesin që duhet të tregojmë ndaj mjedisit. Si përfundim, kohët e fundit kjo çështje ka marrë një rëndësi ekzistenciale për opinion e

gjerë në të gjithë botën.

Kur flitet këtë çështje në opinionin e gjerë botëror duhet të theksohet se: "Të gjithë kemi një shqetësim të përbashkët për brezat e ardhshëm: pavarësisht shumë mbledhjeve konferencave, kompromiseve dhe deklaratave me natyrë politike dhe teknike në rang ndërkombëtar apo rajonal, natyra po shkon drejt shterimit në një gjendje alarmante dhe shqetësuese." Që prej vitit 1995, simpoziumet Klingenthal të organizuara në Alsace, përfaqësojnë një përpjekje me natyrë ndërfaqetare dhe ndër-kulturore në këtë aspekt. Në këtë platformë, për herë të parë në histori fetë si Krishterimi, Hebraizmi, Islami, Hinduizmi, Budizmi, Shintoizmi madje edhe përfaqësuesit e materializmit u mbledhën bashkë për një qëllim të caktuar. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte të sillte bashkë qasjet e ndryshme në lidhje me dimensionin shpirtëror dhe social të natyrës. Të gjithë përfaqësuesit e shteteve deklaruan duke thënë: "Jemi të vetëdijshëm për nevojën e përcaktimit të një modeli të ri të marrëdhënieve midis shoqërive njerëzore dhe natyrës." Kështu në datat 20-26 shtator 2019 në 139 shtete qindra mijëra njerëz i bënë thirrje autoriteteve shtetërore që të merrnin masat kundrejt këtij rreziku. Më 23 shtator 2019, në hapjen e mbledhjes së samitit të kombeve të bashkuara për klimën, sekretari i përgjithshëm Antonio Guterres e hapi fjalimin e tij me fjalët: E gjithë bota po klith duke thënë: "Kthimi pas është i domosdoshëm."

Bash për këtë problem, Kurani Famëlartë na tërheq vëmendjen duke thënë: "U shfaq ngatërresa në tokë dhe në det për atë që punuan duart e njerëzve, që t'u japë të shijojnë pjesë nga ajo që kanë punuar, për t'u kthyer ata në përmirësim."⁵ Ky ajet përmban një paralajmërim në aspektin material ashtu sikurse në aspektin shpirtëror: Shkatërrimet që njerëzit kanë shkaktuar në natyrë, në ditët e sotme kanë marrë një vëmendje të veçantë. Pra, në këtë ajet nuk aludohet vetëm kalbjen morale por në të njëjtën kohë edhe për shkatërrimin i natyrës. Kështu Kurani Famëlartë e fton njeriu të ruajë balancën midis dimension material dhe atij shpirtëror në jetën e tij.

Kur njeriu e shikon këtë çështje në perspektivën e Kuranit, e përjeton atë sikur po i zbritet atij në këtë moment, reflekton dhe vetëdijësohet në lidhje me këto mësim të vyera. Zgjedhjet e gabuara që kanë bërë njerëzit duke vepruar pa u menduar, duke mos marrë parasysh ekuilibrin dhe harmoninë që gjenden në natyrë dhe duke mos i vënë vesh mësimëve hyjnore kanë sjellë proceset si ndryshimin e klimës, ngrohjen globale dhe shkrirjen e akujve. Le të shpresojmë, që të vetëdijësohemi për rreziqet që na kanosen, të marrim masat dhe kthehemi në qenien tonë, duke dhuruar më shumë mirësi dhe kontribuar për përmirësimin e jetës në tokë.

Pr. Dr. Suat Yıldırım

4. Kuran 54:49

5. Kuran 30:41



PROFETI YNË U DËRGON LETËR MBRETËRVE TË KOHËS PËR T'I FTUAR EDHE ATA NË ISLAM I



Profeti ynë i nxit sahabët që të përhapin mesazhin e Islamit

Misuer bin Makhremeja (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi pranë sahabëve dhe tha: "Allahu i Madhërishëm më dërgoi Mua si mëshirë për mbarë njerëzimin. Atëherë – Zoti ju faltë – edhe ju ta kryeni detyrën e predikimit të Islamit në emrin tim. Mos u përplasni me njërit-tjetrin, siç pati ndodhur me apostujt e profetit Isa, sepse edhe profeti Isa u pati bërë thirrje apostujve të tij, njësoj siç po ju bëj edhe unë juve; mirëpo, ata nuk deshën të shkonin në toka të largëta. Isai, i biri i Merjemes, iu lut Allahut, duke ia shfaqur vetëm Atij tërë trishtimin që e pati kapluar si pasojë e kësaj sjelljeje. Dhe, në shumë pak kohë, secili prej apostujve kuptoi se dinte të fliste gjuhën e atij vendi ku do të shkonin për të shpallur fenë e Allahut. Atëherë Isai (alejhis'selam) tha: 'Kjo është, pa dyshim, një detyrë që Allahu kërkon që ta kryeni ju.'" Atëherë, pasi i dëgjuan këto fjalë, sahabët thanë: "O i Dërguari i Allahut, edhe ne do ta kryejmë çdo detyrë që do të na e ngarkosh ti, ndaj ta dish se ti ne mund të na dërgosh ku të duash."

Kur mori këtë përgjigje nga sahabët e Tij, Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi Abdullah bin Hudhafen (radijallahu anhu) te Kiswa; Selit bin Amrin (radijallahu anhu) te valiu i Jemames, Heuzeja; Ala bin Hadramin (radijallahu anhu) te valiu i Hexherit, Mundhir bin Sauij; Amr bin Asin (radijallahu anhu) te dy mbretërit e Mbretërisë së Omanit, dy djemtë e Xhulendiut, Xhejferi dhe Ubadi; Dihjetu'l-Kelbin (radijallahu anhu) te Kajseri; Shuxha bin Uehbin (radijallahu anhu), i cili ishte prej ensarëve, te Mundhir bin Harithi i Gassanive; dhe Amr bin Umejete ed-Damri (radijallahu anhu) te Nexhashiu. Të gjithë këta të dërguar, përveç Ala bin Hadramiut, u kthyen në Medinë para se i Dërguari i Allahut të ndërronte jetë. Vetëm Ala bin Hadremiu gjendej në Bahrejn në kohën kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ndërroi jetë."

Ibni Haxheri, në veprën e tij "Fet'hu'l-Barî", thotë se: "Historianët që janë marrë me jetën e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për ta studiuar, kanë vërejtur se në mesin e emrave të sahabëve të dërguar si mëkëmbës prej tij, kanë qenë veçanërisht këta emra: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka dërguar te Harith bin Abdi Kulali Muhaxhir bin Ebi Umejjen (radijallahu anhu), te Dhul-Kelaja Xheririn (radijallahu anhu), te Musejlemeja Saibin (radijallahu anhu) dhe te Mukaukisi Hatib bin Ebi Beltean (radijallahu anhu)."

Letra e Profetit tonë për Nexhashiun, mbretin e Abisinisë

Ibni Is'haku tregon: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati caktuar Amr bin Umejete ed-Damri (radijallahu anhu) për ta dërguar te Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, që të çonin një letër lidhur me gjendjen e Xhafer bin Ebi Talibit dhe shokëve të tij. Në letër shkruhej:

"Bismil'lahir-Rahmanir-Rahim! Kjo është një letër e të

Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për mbretin e Abisinisë, Nexhashi As'hamin. Përshëndetjet e Zotit qofshin me ty. Lëvduar dhe falënderuar qoftë Allahu, i Cili është zotëruesi më i mirë i cilësive 'Mbret(ërues), i Shenjtë, Besues dhe Mbrojtës Besnik'. Unë të dëshmoj se Isai (alejhis'selam) ishte një shpirt i dërguar prej Allahut, i cili erdhi si një fjalë e Tij, lënë amanet Merjemes, e cila ishte një grua e pastër, e dëlirë dhe shembull i ndershmërisë. Merjemja u zu në barrë me Isain. Allahu i Madhërishëm e frymoi shpirtin e frymën e tij njësoj siç pati krijuar edhe Ademin në fillim, me duart e Tij dhe ia pati frymuar frymën e shpirtin nga shpirti i Vet. Unë të ftoj që t'i besosh Allahut, që është Një dhe i Vetëm, e që nuk ka asnjë ortak në krijimin e gjithçkaje, t'u bindesh urdhrave të Tij, të më ndiqni mua dhe të më besoni, si mua, ashtu edhe atyre të vërtetave që kam sjellë unë. Nuk ka dyshim se unë jam i Dërguari i Allahut. Tek ti kam dërguar djalin e xhaxhait tim, Xhaferin, dhe disa besimtarë të tjerë, të cilët të kërkoj që t'i presësh mirë, e të ruhesh prej fanatizmit. Unë të ftoj, ty dhe ushtarët e tu, që të pranoni fenë e Allahut. Unë e krewa shpalljen time, e t'i kam dhënë të gjitha këshillat e nevojshme. Tani ju takon juve, që të bëni atë që është më e mira dhe e duhura. Paqja e Allahut qoftë me ata që ndjekin rrugën e drejtë."

Letra që Nexhashiu i dërgon Profetit tonë të nderuar

"Bismil'lahir-Rahmanir-Rahim!

Kjo është një letër e Nexhashi As'hamit, i biri i Ebxherit, për të Dërguarin e Allahut, Muhamedin:

"O ti Profeti i dërguar prej Zotit, të përshëndes nga larg me përshëndetjen e Zotit! Mbi ty qofshin mëshira dhe begatitë e Zotit! Nuk ka zot tjetër, veç Atij që më udhëzoi mua në Islam. O i Dërguari i Allahut! Letra që më kishe dërguar për Isain (alejhis'selam) mbërriti tek unë dhe e lexova. Të betohem për Zotin e tokës dhe të qiejve, se Isai nuk ka asnjë cilësi më shumë sesa ato me të cilat ti e kishe përshkruar në letrën tënde. Dëshmitarët e tu që na kishe dërguar, djalin e xhaxhait dhe të tjerët, i mirëpritëm. Unë dëshmoj përpara Allahut, se ti je i Dërguari i drejtë dhe i provuar i Allahut. Unë iu binda e lidha besën me ty e djalin e xhaxhait tënd. Në sajë të tij unë iu dorëzova Allahut, që është i vetmi Zot i botëve. O Profeti i Allahut! Së bashku me këtë letër po të dërgoj edhe tim bir, Berihanë. Unë nuk mund të dal garant për askënd, përveçse për pjesëtarët e familjes sime. Tek të tjerët nuk më ka vlerë fjala. Nëse do që të vij edhe unë tek ti, më thuaj dhe unë do të vij. O i Dërguari i Allahut! Unë dëshmoj dhe pranoj se çdo fjalë e jotja është e vërtetë dhe e drejtë."

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"

M. Jusuf Kandehleui

Botim i KMSH

Rëndësia e gjuhës në jetën e një populli

Gjuha e një populli, vegël e shkëlqyeshme me të cilën njerëzit që banojnë në një pjesë të caktuar të rruzullit mundin me pas marrëdhënie midis syresh e me shfaq mendime e ndjenja të botës së tyre të brendshme, nuk mund të jetë një gjë e vdekur por, përkundrazi, është lëndë e zjarrtë që dalëngadalë mund të sajohet në formën që më tepër i përshtatet evolucionit të vazhdueshëm të popullit që e ka përdorur më parë, që të mund të bëhet në çdo kohë shprehja e gjallë e besnike e naltësimit të vet shpirtëror. Kështu, megjithëse duhet t'i shtrohet disa kushteve të caktuara e ligjeve fonetike, gjuha duhet të jetë përherë një gjë e përkulshme, e kthyeshme, e zonja me kënaq ndjenja harmonie të reja, me u pasurue me fjalë të reja që i lyp nevoja, pa humbun e pa braktisun, megjithëkëtë, ato fjalë që janë shprehja karakteristike e strukturës dhe e veçorisë së saj gramatikore e sintaksore, dhe pa marrë asgjë të huaj për të mos humbur në dëlirësi çka kishte me fitue në një terminologji të bollshme.

Gjuha asht një nga elementet etnike kryesore të një populli e prandaj ngrihet në një kuptim simbolik të lartë: asht si një flamur i gjallë e i dashtun i gjindve të unisuem nga zakone të përbashkëta, nga veti fizike e morale të veçanta, nga përshkrime ndodhinash historike, asht si zani i tokës amësore që çohet lart nga malet, pyjet e detrat që përbajnë atdheun e dashtun. Asht burimi kryesor i traditës e i historisë dhe lejon që këto - shkas krenarie për një vend - të mos shfitytrohen e dhunohen nga dashakeqësit ose nga interesat e kundërta të popujve të huaj.

Zbulimet arkeologjike, zë i shtremët por edhe i naltë i një të kalueme të largët, shndritin e përqethen me jetë të re kur fjala e stërgjyshave tanë të largët - mbërritur deri te na në formën e traditës me anë shkrimi a goje ose në veshjen ma shkencore të historisë - përshkruajnë ambëlsisht domethënien e atyre gërmadhave të pluhurosura.

As duhet harruar se nga gjuha e një populli të përparuar qytetnisht e shpirtërisht nxirren ato fjalë që, artistikisht të seleksionuese e të grumbulluese me vend, u japin madje jetë përmendoreve letrare që janë lumnit ma të shkëlqyeshme të një kombi.

Një dijetar pat thanë se "fjalët e një gjuhe janë si rrasa e ngjyrave të piktorit që e bajnë kuadrin të shëmtuar ose të bukur sipas vleftës e zotësisë së artistit". Dhe me të vërtetë ndër fjalët asht gama, delikate ose e ndezun, e ndjenjave tona, ndër to gjejmë hijet e dritat e mendimit tonë: fjalë të thella e të menduara për të shprehun dyshimet, mundimet, ngadhënjimet e mendjes; fjalë të lehta e të shndritshme me të cilat shfaqet poezia dhe muzika që përshpërin në shpirt; fjalë bindëse, plot dashuni e paqe që çon nalt në qiell shikimin.

Kësisoj çdo popull gjen në idiomën e vet ushtimin trendës të shpirtit të përbashkët dhe pikërisht për këtë punohet si entitet kombëtar e bahet i njohur ndaj të huajve; pret si një fletë e shumëfuqishme ajrin e shekullit dhe shkon guximshëm me takue ledhën dehëse e të panjohur të lumnive të kohës së ardhme.

Në asht se, siç pat thënë Buffon-i "Stili asht njeriu" gjithaq e vërtetë asht se gjuha - në një shikim më të gjerë e më pak individual - asht kombi vetë, asht përshtjellimi njerëzor bamë ma kompakt e i pandashëm nga përbashkimi i jetës dhe i aspiratave nga trashëgimi i ngadhënjimeve dhe i vuajtjeve që i takon nga një e kaluar e përbashkët.

Pikërisht për këtë gja të gjithë patriotët e mëdhenj shqiptarë kanë ndimun përherë një dashtni të fortë e të devotshme ndaj idiomës sonë kombëtare, për këtë asht që popujt e ndryshëm ngadhënjyes janë mundue më kot me ngjir zanin harmonik e të fuqishëm që prej kohëve të largëta të ilirëve e më parë nget drejt lumnive të arta të Shqipërisë, simbol fuqie e zemërgjanësie, etje lirie e kryenaltësie të papërkulun kurrë.

Që atë kohë shekujt pasuan shekujt dhe zbritësat e racës së fortë ilire njohën shumë herë peshën e idhët të sunduesit të huaj, por idioma e tyre megjithëse nuk mujt me pas një atë zhvillim e atë përsosuni që do të kishte mujtë me i dhanë një regjim i lirë, u ruajt me xheloz të madhe si një gur i çmueshëm që vërtet nuk asht punuar, por që dora e aftë e mjeshtrit lehtësisht mund ta vërë në dukje shkëlqimin e fshehtë dhe ta bëjë që të shndritë me të njëmijë dritat rrënjyese tue gdhend e tue lërue vetëm prej tepricave të kota.



Pra, një kështu Frashëri, Fishta, Mjeda – për me kujtue këtu vetëm të madhejt tanë të kohëve më të afërta - janë munduar me ambëlisinë e rreshtit të tyre e due studjue me dashtni të gjithë problemet, me i dhanë gjuhës amësore një elegancë formash ma moderne, me përcaktue alfabetin e pasun dhe me kundrue në dritën e studimeve të përkujdsshme të etimologjisë e të filologjisë së krahasuese.

Në këtë mënyrë literatura shqiptare ka fillue me dhanë lule bukurie të mrekullueshme që kanë sjellë një erëkandje të re e të veçantë në kopshtin e gjanë e përherë të lulëzue të letërsisë së përbotshme.

Gjuha shqipe paraqet megjithëkëtë pika të errëta e probleme që lypin studime të kujdesshme e të thella për me sqarue rrugën që të çon drejt një solucioni të kënaqshëm. Duhet me u shpallë e përcaktue rregulla gramatike e sindaktike në mënyrë që - edhe pa qenë nevoja me i heq gjuhës plasticitetin e saj të duhun – të jenë prisa të drejtë për shkrimtarin, e që të mundi ky me lëviz mbi një bazë të qëndrueshme e të sigurt. Atëherë, e vetëm atëherë gjuha letrare ka me fitue një njësi ma të madhe stili, një strukturë ma koherente e të saktë.

E nxjerrë nga polimorfizma e tashme dhe e marrë nga një drejtim më linear do të jetë ma lehtë për artistin me i dhanë gjuhës atë kthjelltësi dhe hollësi pende të aftë për ta ba një vegël tingëllimesh të përkryeme.

Na dimë se gjuha asht si një kuti ideale që ndan edhe aty ku caqet gjeografike nuk shënohen dhe asht si një urë ideale që bashkon edhe aty ku padrejtësia e njerëzve ka dashtë me nda vëllazën: - me e dashtë gjuhën amësore, me u mundue me e ba përherë e ma të bukur e të përsosun, me e përhapë dhe me vu në dukje melodi poezie ose proze të kulluara, me ba që me u këndue ambëlisht e në formë përkëdhelëse dashnit familjare, janë të gjitha mënyra si me dëshmue nacionalizmin e vet.

Nuk asht vetëm me mjete fuqie që luftohet për me pohue madhnië dhe lirinë e atdheut të vet ndaj botës së qytetnueme, shpesh atdheut i jepet ma fort dritë prej shkëndijës së qetë e të padallueshme që shpërthen nga vepra e një shkrimtari ose oratori gjenial, se sa nga zhveshja

e armëve e nga përdorimi i mjeteve të shkatërrimit që sado të shënjtueme që të jenë nga dliresija e idesë që të ban me i rrok, prapë triumfi ose jo i tyne mvaret nga rrethanat e çastit.

Sallust-i thotë: Ma dobi ka me pas shteti nga argtimi i jem (puna ime letrare) sesa nga aktiviteti politik i të tjerëve.

Fatkeqësisht lakmia e të huajve, prepotenca e ma të fortëve, bajnë shpeshherë të nevojshëm që Atdheu të lypë prej bijve të vet një mbrojtje me armë dhe një flini jetësh mu në lulen e rinis, por edhe në këto çaste tragjikisht vendimtare për jetën e kombit, e madhe asht fuqia e oratorit, pohimi i mprehtë dhe objektiv i historikut, e deri fjalët e përvujtura por të thjeshta të gjuhës popullore kanë një ndikim të madh në shpirtin e turmës që tue naltue dashurinë ndaj Atdheut, tue e nxit atë në rrezikun ma të madh, zgjojnë tek ai atë rreshk flijimi që të çon në heroizmat ma të përlarta.

Dhe një punë e tillë asht vërtetue gjithmonë në të sjelljet e mëdha historike e shoqnore që kanë pasue kohët dhe, nëse ngandonjëherë njerëz të mbrapshtë kanë përdorur keq këtë dhunti të bekueme të Zotit tue e drejtue kah veprimtarina fatzeze e shkatërrimtare, të panumërt janë ata që për fat të mirë të njerëzimit kanë përdorur fjalën si një vegël mirësi ndaj vëllazëve të vet.

Asht pra një detyrë e përcaktue me e dashtë, me e lëvrue dhe me e përkrye gjuhën shqipe, këtë gjuhë që krenohet për një traditë lumnie të gjatë, në mënyrë që kjo të mundë me i dhanë theksimet e veta harmonike të mendimit të breznisë mocatare, tue vijue e denjë veprën e ndërmarrun prej parardhësve fisnikë; asht detyra jonë me e përpunue dhe me e naltësue gjuhën aq sa të jemi të sigurtë me i folë botës për këtë Komb të vogël, por të moçëm e qëndrueshmërisht trim, veçanërisht me dëshmue ndaj mbi përparimin shpirtëror të tij, ndërsa pasunit e tjera janë të brishta, ato të përpunueme prej shpirtit jetojnë në amshim. Na kujtohen me këtë rast fjalët sa të bukura aq edhe të drejta të Sallust-it se "përpjekjet e lume të zotëris mendore bahen të pavdekshme, si shpirti prej të cilit rrjedhin."

Jolanda Kodra

Botuar në revistën "Njeriu", nr. 3(27), shtator 1944.



Teolog, studiues dhe atdhetar i shquar

Hasan Selami (1910–1943)

Hasani ka lindur në fshatin Kallarët të rrethit të Vlorës më 1910. Shkollën fillore e kreu në fshatin e vet, në shtëpinë e kushëririt të tij, Bajram Bajramit, rreth vitit 1922. Shkollën qytetëse (7 vjeçare) e kreu në Vlorë duke punuar e shërbyer në dyert e të pasurve, për të siguruar bukën e gojës si dhe për të fituar djjet e nevojshme. Pastaj i doli e drejta e studimit për të vazhduar Medresenë e Përgjithshme në Tiranë. Në vitin 1935 kreu studimet në Medrese duke u diplomuar me gradën "E Lavdërueshme". Ai ishte shumë i aftë sidomos

në mësimin e gjuhëve të huaja. Kishte sjellje shembullore, ishte i shoqëruar e i përvuajtur. Shkolla e pajisi Hasanin, si të gjithë nxënësit që studionin në të, me ndjenja të thella fetare e kombëtare.

E gjithë jeta shkollore e tij qe studim e mirësjellje. Me këto virtyte të shquara fitoi admirimin e shokëve, dashurinë e profesorëve dhe simpatinë e drejtuesve të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Që kur ishte ende nxënës në Medrese ai jepte mësim

në klasat e ulëta të kësaj shkolle dhe me mbarimin e studimeve në të, u emërua vaiz shëtitës në dispozicion të Komunitetit Mysliman, duke qenë edhe asistent profesor në Medrese. Për gati dy vjet vazhdoi të predikonte në xhamitë e Tiranës, Durrësit, Kavajës, Lushnjës, Fierit, Beratit, Elbasanit, Pogradecit, Korçës, Gjirokastrës etj. Në predikimet që bënte Hasani, sipas njoftimit që bënte myftinia e rrethit përkatës, merrnin pjesë, përveç popullit mbarë, edhe intelektualë të qytetit, pa dallim besimi. Të gjithë largoheshin të kënaqur, sepse temat që zhvillonte e nxisnin popullin nga puna, qytetërimi dhe morali. Ato ishin prekëse, të bazuara në Kur'an e në porositë e Hz. Muhamedit (a.s.), të vërtetuara e të zbukuruara me fjalët e shumë dijetarëve islamë ose nga ata të perëndimit. Me temat që trajtonte, ai i tregonte botës shqiptare se Medreseja e Përgjithshme përgatiste kuadro të shquar.

Kryesia e Komunitetit Mysliman Shqiptar mendonte t'i jepte detyra nga më të lartat që lejonte rregullorja e shkollës, por Hasani nuk donte detyra, ai donte të shtonte dijenitë fetare e të përgjithshme. Prandaj, aty nga mbarimi i vitit 1936 shkoi në Egjipt dhe u regjistrua në Universitetin e Ez'herit në Kajro. Profesorët, duke u mbështetur në aftësitë e tij, si dhe në përvojën e fituar kur ishte vaiz shëtitës në Shqipëri, pranuan që ta regjistronin student të rregullt në specialitetin e vaizit dhe të irshadit.

Hasan Selami zotëronte virtut të lartë dhe moral të pastër. Ishte i aftë, i pastër, i ndershëm, i sinqertë, modest, serioz e i vullnetshëm. Nuk e kalonte kohën kot dhe dëshironte, duke qenë student, të kryente plotësisht misionin që i kish ngarkuar Komuniteti Mysliman.

Ai në të njëjtën kohë u regjistrua edhe në Universitetin Amerikan të Kajros, në degën e letërsisë e të pedagogjisë. Edhe aty kishte fituar një simpati të madhe.

Ishte njohës i arabishtes, anglishtes, persishtes, frëngjishtes e italishtes, të cilat i zotëronte në mënyrë perfekte.

Në verë të vitit 1939 fitoi doktoraturën në "Predikim e Thirrje në Islam". Fotografia e këtij studenti shqiptar zbukuroi faqet e disa fletoreve të përditshme të Egjiptit, megjithatë ai nuk krenohet aspak për titullin e studimit që kish fituar. Ai gjithmonë shprehej: "Dituria s'ka fund dhe unë di vetëm që s'di asgjë".

Në verë të vitit 1939 erdhi në Shqipëri e qëndroi vetëm dy muaj. Ai nuk kishte ndërmend dhe as që mori ndonjë detyrë. Qëllimi i tij kryesor ishte që të vazhdonte studimet e të kryente edhe një ose më tepër fakultete të tjera në Kajro. Në vjeshtë të vitit 1939 shkoi përsëri në Egjipt, me bursë të Komunitetit Mysliman për të studiuar "Historinë Islame", d.m.th. për të fituar edhe një specializim në këtë degë. Shkoi përsëri në Kajro për të mos u kthyer më, për të mbetur përgjithmonë në dhe të huaj.

Hasan Selami Kallarati ndërroi jetë në Kajro më 15 korrik 1943, në moshën 33 vjeçare. Periudha nga 1939-1943 janë plot katër vjet shkollë. Sigurisht, gjatë kësaj kohe i ndjeri Hasan do të ketë bërë punë të madhe. Mirëpo vdekja, që

është rrugë për t'u përshkuar nga të gjithë, ia preu hovin duke e ndarë nga kjo jetë në një moshë që ishte mbushur me dije. Me okupimin e vendit tonë nga Italia fashiste, ai si atdhetar përparimtar, grumbulloi rreth vetes shumë studentë të huaj e shqiptarë dhe shkoi e protestoi përpara përfaqësive të huaja të akredituara në Kajro, duke thënë midis tjerash: "Ç'kërkon fashizmi italian në Shqipëri, ajo nuk i ka borxh askujt, prandaj ata duhet të kthehen nga kanë ardhur" etj.

Hasani, duke qenë me studime në Kajro, ka pasur korrespondencë për çështje gjuhësie me rilindasin e studiuesin Sotir Kolea, i cili ka edhe një korrespondencë me letra që daton më 10 korrik 1937.

Duke qenë nxënës në medrese dhe predikues, ai ka dhënë një kontribut të madh me shkrimet dhe përkthimet e veta në revistat fetare-kulturore "Zani i Naltë", "Kultura Islame", siç mund të përmenden artikujt "Ç'urdhëron Perëndia në Kur'an", ku, pasi komentohet sure "El Asr" shprehen mendime të tilla si: "Do ta përparojmë e do ta lulëzojmë atdheun, nëse do të kemi frikën e Perëndisë, do të mbajmë sedrën e shqiptarit e do të pajisemi me vullnet të fortë", ose "E kemi detyrë fetare të përvetësojmë e të përgjithësojmë çdo përparim... përparimin madhështor të perëndimit".

Në artikullin "E vërteta mbi xhizjen" thotë se ajo është një taksë që paguhet si shpërblim për mbrojtjen e jetës dhe të pasurisë së nënshtetasve jomyslimanë (të kujton institutin e sigurimeve sot në vendin tonë).

Nga "The light" në 13.5.1932 ka përkthyer vjershën kuptimplotë "Profeti dhe jahudiu". Janë për t'u përmendur në një rast 20 fjalë të arta të Hz. Aliut nga të cilat po shkëpusim tre: "Mos u dëshpëro për vonimin që shkaktohet në pranimin e lutjes sate, se, sa më shumë të jetë vonimi, aq më e madhe bëhet dhurata"; "Mos iu frikëso asnjë gjëje veç mëkatit tënd e mos i zë besë askujt veç Zotit të plotfuqishëm" dhe "Mëso dituri prej cilitdo që ta mëson, çmoje vlerën e diturisë dhe mos mendo cilësinë e mësuesit".

Nga shkrimet e përkthimet e shumta të tij, do të veçojmë edhe vjershën "Hymni mysliaman shqiptar", botuar nga Imam Vehbi Ismaili në librin "Islamizmi dhe lutjet" (botim i tretë i përmirësuar) nga mund të shkëpusim vargjet:

"Unë në shpirt
e kam dashurinë e fesë,
i lutem, pra, Zotit,
mysliaman të vdes".

Idealet e Hasan Selamit do të kurorëzohen në jetën e pasosur sepse Profeti (a.s.) ka thënë: "Ai që vdes duke kërkuar dituri, vdes dëshmor (shehid)".

Kjo figurë poliedrike islame, do të jetë shembull i madh për të gjithë nxënësit e sotëm e të ardhshëm të medreseve në Shqipëri!¹

1. Shahaj, Hito, (myfti i Vlorës), dorëshkrim, Vlorë, 2012; Gani, Remzi, gazeta "Drita Islame", nr. 95, 1996: 3.

Divorci nuk e vetmja zgjidhje

Të gjithë dëshirojmë të kemi një martesë të lumtur e plot harmoni por ndonjëherë krijohen situata të cilat e sforcojnë martesën e të shtynë drejt divorcit.

Një martesë e lumtur, zgjedhja e personit të duhur është ëndrra në sirtar e shumicës prej nesh dhe secili e hedh këtë hap duke menduar pozitivisht . Por pas njëfarë kohe përballemi me fundin e martesës pa arritur ëndrrat e mëparshme. Sigurisht që zgjedhja e divorcit nuk është e menjëhershme por vjen si pasojë e shumë zhgënjimeve, mosmarrëveshjeve në çift . Në këtë proces çiftet lodhen nga njëri-tjetri dhe fillojnë të kërkojnë një zgjidhje . Ekzistojnë disa faktorë të cilët ndikojnë në marrjen e një vendimi të tillë dhe njëri apo më i rëndësishmi është mosnjohja e nevojave dhe ndryshimeve të njëri-tjetrit. Asnjëherë nuk e vendosim veten në vendin e personit përballë për t'u munduar të kuptojmë pritshmëritë, nevojat e kërkesat e tij/saj.

Le të japim disa shembuj

Femrat zakonisht kërkojnë të dëgjohen , të mirëkuptohen dhe të shkëmbejnë mendimet në lidhje me një problem të caktuar. Por nga ana tjetër burrat nuk mund të jenë dëgjues shumë të mire , nuk i kuptojnë mire grate dhe si rrjedhojë i ofendojnë me reagimet e tyre. Në momentin që nuk shohin mirëkuptim dhe nuk dëgjohen atëherë fillojnë të distancohen e ftohen nga partneri duke krijuar mosmarrëveshje nga më të ndryshmet. Nga ana tjetër nëse i hedhim një sy reagimit të burrave përballë një problemi është se ato përpiqen ta zgjidhin vetë pa përzier të tjerë. Por ky reagim keqkuptohet nga gratë të cilat e interpretojnë si mosvlerësim nga partneri, mosndarje të problemeve me njëri-tjetrin .

Nga ana fiziologjike burrat funksionojnë në këtë mënyrë, të pavarur në zgjidhjen e problemeve, në mospërfshirjen e partneres dhe e pare nga ky aspect përpiqen të mos e ngarkojnë por tja lehtësojnë barren që kanë me ngarkesat e tjera. Kur nuk shihet nga ky këndvështrim do kemi keqkuptime nga grate , acarim të situates deri në mosmarrëveshje.

Problemet i zgjidhim në mënyra të ndryshme

Femrat kërkojnë më shumë vëmendje , interes, komunikim e kalim të kohës bashkë. Kur nuk marrin përgjigjen e kërkuar ndihen të pavlerësuara dhe bëhen më agresive . E njëjta gjë ndodh edhe me fëmijët , një fëmijë i cili nuk merr vëmendjen e duhur fillon të shfaqë sjellje agresive. Edhe për meshkujt mund të themi të njëjtën gjë por me një ndryshim të vogël , ato nuk dëshirojnë të jenë në komunikim të vazhdueshëm apo të kalojnë gjithë kohën bashkë sepse kjo i kufizon në veprim. Nëse femrat e njohin këtë anë të burrave duhet ta pranojnë se edhe ato kanë nevojë të kalojnë pak kohë vetëm dhe këtë nevojë ta presin me mirëkuptim.

Shumë të ndryshëm në kërkesat bazike

Meshkujt kërkojnë të ndihen të fortë dhe të mjaftueshëm për veten e familjen dhe për ta ruajtur këtë ndjenjë kërkojnë miratim dhe aprovim nga partnerja. Në momentin që partnerja lavdëron apo miraton një veprim apo sjellje të bashkëshortit ajo ka arritur të përmbushë ndjenjën e mësipërme. Por në disa çifte e vëmë re se kjo nevojë apo kërkesë nuk përmbushet si duhet dhe në të kundërt të kësaj disa femra vazhdojnë të sillen së nënat duke u përpjekur të ndërhyjnë , të kritikojnë çdo veprim të bashkëshortit Në raste të tilla burrat preferojnë të mbyllin veshët dhe të mos dëgjojnë , të mbajnë qëndrim të sertë dhe të largohen nga bashkëshortja.

Prandaj në një çift partnerët duhet të njohin mire nevojat e kërkesat e njërit-trejt , t'i respektojnë ato dhe te përpiqen në maksimum në plotësimin e tyre sepse nëse veprohet kështu do kemi më pak mosmarrëveshje.

Mungesa e komunikimit, shkak kryesor i divorcit

Komunikimi është pjesë e pandarë e jetës sonë të përditshme por ka probleme të cilat e pengojnë atë dhe i hapin rrugë grindjeve. Një nga problemet më të shpeshta që vihet re në grindjet apo diskutimet e një çifti është se secili prej tyre pretendon se ka të drejtë . Ne vend të fokusimit tek zgjidhja e problemeve çiftet mendojnë sesi të gjejnë rrugën e të pasurit të drejtë dhe si rrjedhojë nuk arrijnë të gjejnë një zgjidhje.

Nëse do të dëgjonin njëri-tjetrin me qetësi e vëmendje



pa ofenduar e cënuar lirinë e secilit do ta gjenin zgjidhjen për një kohë shumë të shkurtër. Por fatkeqësisht në ditët e sotme preferojnë të mbajnë inat, të mbrojnë mendimin e vet si më të drejtin duke hapur humnera të mëdha në komunikim dhe duke ju afruar sa më shumë divorcit.

“Si të mbroj veten?”

Një problem tjetër në marrëdhënien në çift është nënvlerësimi i palës përballë , tallja me të dhe vendosja e nofkave tallëse. Këto qëndrime e lëkundin thellësisht ndjenjën e dashurisë e të respektit .

Një factor tjetër i cili ndikon në divorc është mungesa e pasionit dhe rënia në monoton. Shpeshherë përballlemi me çifte të cilët nuk e pëlqejnë më njëri-tjetrin, nuk ndihen mire kur janë bashkë dhe çdo gjë u duket e zakonitë . Në këto çifte vëmë re se partnerët nuk arrijnë të ndajnë kohë për njëri-tjetrin, pra si partnerë nuk arrijnë të bëjnë diçka bashkë , thjesht jetojnë bashkë nën titullin e prindit duke luajtur vetëm rolin e nënës dhe të babait. Nuk arrijnë ta kuptojnë se akoma janë burrë e grua . Martesën mund ta krahasojmë me një zjarr të ndezur të cilin për ta mbajtur ndezur duhet hedhur vazhdimisht drurë . E njëjta gjë është edhe për martesën , nëse dëshironi ta mbani të gjallë duhet të përpiqeni , të sakrifikoni dhe të dhuroni dashuri e respect pa u lodhur. Çiftet duhet të gjejnë kohë për vete edhe pasi bëhen prindër dhe këtë mund ta bëjnë shumë mire me ndihmën e gjyshërve apo të afërmeve që kanë. Një here në javë fëmijët mund të lihen diku te njerëzit tuaj në mënyrë që të realizoni një shëtije , drekë apo darkë në çift. Kjo gjë duhet përsëritur shpesh në emër të ruajtjes së emocionit e gjallërisë në çift.

Një tjetër factor i cili ndikon në divorc është dhe tradhtia e problemet seksuale. Seksualiteti është një temë e cila nuk përfillet në shoqërinë tone dhe konsiderohet si tabu . Fatkeqësisht në shumë raste vlerësohet me informacione të gabuara të marra nga jashtë. Nisur nga kjo njerëzit nuk përpiqen t’i zgjidhin problemet e jetës seksuale me një specialist të fushës dhe refuzojnë të marrin ndihmë. Ato preferojnë të jetojnë me këto probleme me vite me rradhë por kjo gjë e dëmton seriozisht marrëdhënien në çift .

Problemi fillon të pasqyrohet më pas edhe në sjelljet e partnerëve të cilët fillojnë të bëhen më agresivë e cinikë. Prandaj është shumë e rëndësishme që të ndërmerren hapa të matur e të informuar drejt martesës në mënyrë që të shmangen probleme të tilla.

A ndikon media sociale në faktorët që të shtyjnë në divorc?

Media sociale është shndërruar në një fushë e cila sa vjen e po merr më shumë kohë . Ditëve të sotme kemi familje që e ndajnë të njëjtën shtëpi , tryezë pa komunikuar fare . Bëhen takime apo vizita të ndryshme tek familjarët por qëllimi i vetëm është të bëhen foto e të ndahen në media sociale. Parë nga ky aspekt media sociale ndikon në ftohjen , distancimin e familjarëve dhe pakësimin e aktiviteteve të përbashkëta.

A duhet të ndërhyjnë familjarët?

Shoqëria jonë është një shoqëri e cila pëlqen ndihmesën , mbështetjen e tjetrit. Por ka raste kur familjet në emër të ndihmesës më shumë prishin punë se rregullojnë. P.sh nënat dhe baballarët kur marrin vesh për problemet fillojnë të mbajnë qëndrim ndaj nuses ose dhëndrrit nisur nga mendimi se i ka mërzitur vajzën apo djalin. Në këta raste sugjerohet mos informimi i familjarëve rreth problemeve të çiftit sepse situata përkeqësohet dhe bëhet më e bezdisshme.


Në martesë është e mundur të mësosh rrugët e lumturisë . Kur çiftet përballen ne një problem dhe nuk arrijnë të gjejnë zgjidhje atëherë le të kërkojnë ndihmën e një specialisti. Me disa metoda apo sugjerime të thjeshta mund të bëhen ndryshime dhe të rikthehet harmonia në çift. Dhe sigurisht të përpiqen të bëjnë të pamundurën për të mbrojtur foleën e tyre familjare . Por në rast se është e pamundur të vazhdohet më tej atëherë le të provojnë divorcin si zgjidhje.

Aisa Kokiçi



BOTIMET KMSH

MUND T'I GJENI PRANË LIBRARISË "MIQTË E LIBRIT"



WWW.KMSH.AL



BOTIM I RI